

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7570 E martë 26 Qershor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion i Ditës

Kryeministri shqiptar e ka nxjerrë kokën nga gropa ku e kishte fshehur si struci për të sulmuar ata që u frynë borive të alarmit për ngritjen e kampeve ...
Vijon në faqen 20

Nga ANDI BUSHATI

Si e zhvlerësoi Macron bastin e Ramës



Dje në "Reuters"

Nga ROBIN EMMOT

Bashkimi Europian është i ndarë blidhur me vendimin nëse do të lejohet hapjen e bisedimeve të anëtarësimit me Shqipërinë dhe Maqedoninë ...
Vijon në faqen 21

Tri vende të BE kundër hapjes se negociatave me Shqipërinë



Bjarke Ingels mori 21 çmime ndërkombëtare

U vlerësua nga 'Time' e 'Wall Street Journal', kush është arkitekti i Teatrit të ri Kombëtar

Arkitekti i njohur, studio me 400 punonjës. Projektoi "Two World Trade Center" në SHBA

Arkitekti danez, Bjarke Ingels, është projektuesi i Teatrit Kombëtar në kryeqytet. Themelues dhe partner i "Bjarke Ingels Group" (BIG), 43-vjeçari vlerësohet për konceptet sociale në arkitekturën e tij. Studio e Bjarke Ingels numëron një staf prej 400 personash. Ai ka ndërtuar një sërë objektiv, që i kanë dhënë emër në botë ...
Në faqen 17

NE KERMIM ELVIS DHE ALFRED VLADI, TE ARRESTUAR ME HERET PER DROGE E TRAFIK MJETESH

3.4 MILIONE EUROT, POLICIA: POROSI E DY VELLEZERVE

Detajet e operacionit, 4 të arrestuar, sekuestrohen 10 makina dhe një kallashnikov. Pronari i firmës së transportit, i dënua me arrest shtëpie



(Në foto) Alfred Vladi, Elvis Vladi, Edi Lika, Alban Mollaymeri. "Toyota" me eurot në portin e Durrësit

Në faqen 2-3

PERPLASJE PS-PD

Basha: Për 3.4 milionë eurot më thanë të huajt. Balla: Histori babaleje

Në faqen 4

DOKUMENTI

Kontrata e re e PD, marrëveshje me lobistë afër Trumpit në SHBA

Në faqen 5

6 FAKULTETE

Zbardhen kriteret e pranimit në Universitetin e Tiranës

Në faqen 12

PERMBYTJA

Shiu i verës "Iar" 12 mijë botime në Bibliotekën Kombëtare

Në faqen 19

INSTITUTI I SIGURIMEVE



Pensionet, rritja prek ushtarakët, sa do të përfitojë secila kategori

Në faqen 13

Denoncimi/ Pronarët e tokës u gënjyen nga ndërtuesi: Policia u bë palë me të

Dështimi i Krimit Ekonomik liroi mashtruesin

Familja Hametaj: Ja si na e grabitën tokën, bashkëfajtor Marsel Dulaj

Nga DORJANA BEZAT

TIRANE - "Na e kanë vjedhur pronën në bashkëpunim me seksionin e Antikrimit Ekonomik në Policinë e Tiranës". Kjo është lëngata e familjes Hametaj. Prej më shumë se 2 vitesh ata trokasin në dyert e Poli-



cisë së Tiranës dhe konkretisht në Seksionin e Krimit Ekonomik, i cili drejtohet nga Marsel Dulaj. Ata kërkonin ndihmë për të zgjidhur konfliktin me ndërtuesin që u ka marrë pronën dhe nuk u ka dhënë pjesën që u takon nga ndërtimi sipas kontratës ...

Në faqen 9

“TOYOTA” ME EURO OPERACIONI

Kush është Edi Lika, administratori i firmës që transportonte makinat me paratë

Eurot në Durrës, porositësit të arrestuar për kokainë e trafik makinash

Zbulohet e shkuara kriminale e Elvis dhe Alfred Vladit

Ina Allkanjari

Pas bllokimit të sasisë prej 3.4 milionë euro sh dy ditë më parë në portin e Durrësit, zbardhen të tjera detaje lidhur me personat e përfshirë në këtë ngjarje. Kujtojmë se eurot ishin fshehur në pjesën e pasme të dy automjeteve "Toyota" me tek derë, të ngarkuar në kamionin me targë AA 120SP së bashku me 7 automjete të tjera. Ndërkohë, burime thonë se 4 persona janë aktualisht në statusin e të ndaluarit. Edi Lika, administratori i firmës dhe trajnerit që transportonte makinat, djali i tij Klevi Lika që shoqëronte ngarkesën, shoferi i kamionit Agim Ceka dhe shtetasi Alban Mollaymeri janë ndaluar dhe pritet të përballen me disa akuzat. Po sipas burimeve, edhe 2 persona të tjerë janë shpallur në kërkim, konkretisht Elvis Vladi dhe Alfred Vladi. Por administratori i firmës që transportonte makinat, Edi Lika nuk është një emër i panjohur për drejtësinë. Në dy raste, ai është dënuar për krime në familje dhe në një të mëparshëm është përmendur në një aksident automobilistik, kur mjeti - me të cilin ai udhëtonte bashkë me dy vajza, - u përplas me automjetin që drejtohej nga Ledio Ruçi, djali i kreut aktual të Kuvendit. Siç thonë burimet, 41-vjeçari Edi Lika ishte dënuar me "arrest shtëpie" për dy vite nga Gjykata e Apelit. Vepra për të cilën ai akuzohet është ajo e dhunës në familje ndaj të birit, Klevi Cani Lika. Ngjarja ka ndodhur në fund të vitit 2017, sipas burimeve, dhe Edi Lika gjatë një drekte me familjen, pasi ka konstatuar se porosia nuk ishte e njëjtë me çfarë kishte kërkuar, ka qëlluar me shishe në kokë të birin. Lika është dënuar edhe më herët, po për dhunë në familje, ndaj bashkëshortes, ndërsa në



Edi Lika, administratori i firmës dhe trajnerit që transportonte makinat



Elvis Vladi, ish-pallur në kërkim

vitin 2011, ai u arrestua për një aksident automobilistik në Tiranë, gjatë të cilit humbjetën një shtetase. Mjediset e firmës në rrugën "Niko Avrami", ku deklarohet se kryhej aktiviteti i auto servisit, ndodhen në një zonë periferike të Tiranës e njohur ndryshe si "Fusha e Druve". Ndonëse policia ka ushtruar kontroll në këto mjedisë, të hënën puna në

këtë biznes vijonte normalisht. Gjithashtu edhe dy personat e tjerë të përfshirë në ngjarjen në Portin e Durrësit, Elvis Vladi 38 vjeç dhe Alfred Vladi 33 vjeç, të cilët aktualisht janë shpallur në kërkim, nuk janë emra të panjohur për policinë. Të dy këta persona, të cilët dyshohet se janë porositësit e makinave që po transportoheshin nga Belgjika në Dur-

EDI LIKA

Edi Lika nuk është një emër i panjohur për drejtësinë. Në dy raste, ai është dënuar për krime në familje dhe në një të mëparshëm është përmendur në një aksident automobilistik, kur mjeti me të cilin ai udhëtonte bashkë me dy vajza u përplas me automjetin që drejtohej nga Ledio Ruçi, djali i kreut aktual të Kuvendit. Siç thonë burimet, 41-vjeçari Edi Lika ishte dënuar me "arrest shtëpie" për dy vite nga Gjykata e Apelit.

rës, brenda të cilave u gjetën dhe paratë, janë akuzuar më parë për përfshirje në trafik droge në Britaninë e Madhe dhe Francë. 38-vjeçari Elvis Vladi rezultoi në arrestuar bashkë me tre shqiptarë të tjerë në Britaninë e Madhe më 19 maj 2015, gjatë një operacioni ku u sekuestrua një sasi prej mbi 10 kg kokainë. Ata u akuzuan pjesë e një



"Toyota Yaris" që u bllokua në Durrës

Franca në Shqipëri. Gjithashtu, zbulohet roli i një prej katër të arrestuarve deri më tani nga Policia e Shtetit, shtetasi Alban Mollaymeri, 40 vjeç, lindur dhe banues në Tiranë. Mësohet se Mollaymeri është personi që kontraktoi transportuesit e makinave. Nuk dihet ende nëse Mollaymeri u porosit nga dy personat e shpallur në kërkim, por hetimet e mëtejshme të policisë pritet të hedhin në shumë dritë në këtë drejtim.

SEKUESTRIMI

Rreth orës 15:00 të së dielës në portin e Durrësit u bllokua një sasi e madhe parash cash në valutë të huaj. Konkretisht rreth 3.4 milionë euro mësohet të jenë fshehur në pjesën e pasme të dy automjeteve "Toyota", të ngarkuar në një kamion me 7 automjete të tjera. Burime nga policia

Ankona. Raportohet se pre- rja e kartëmonedhave është 20-she, 50-she dhe 100-she. Gjithashtu, mësohet se mjetet ku u gjetën paratë, dhe mjetet e tjera të cilat ndodheshin në auto-tren, ishin porositur për shitje në Shqipëri. Autoritetet shqiptare janë duke hetuar për dërguesin si dhe porositësin e mallit, ndërsa po kontrollojnë edhe dokumentacionin e makinave. Në Portin e Durrësit mbërritën menjëherë krerët e policisë së këtij rrethi. Konkretisht drejtori ashtu dhe nëndrejtori i Drejtorisë së Policisë së Durrësit po ndjekin nga afër hetimet dhe procedurat hetimore. Gjithashtu, policia ka nisur hetimet mbi dokumentacionin e mjetit, ndërsa mësohet se kamioni me targa AA 120SP ishte në pronësi të shtetasis Edi Lika. Dyshohet se paratë e sekuestruara të jenë para të siguruar nga aktivitetet kriminale. Në një prononcim për Neës24, gjyshi i Klevisit, i cili ndodhej në port thotë se nipi i tij kishte 3-4 muaj që merrej me transportin e makinave dhe se djemtë e tij kanë një servis automjeteve. "Policia erdhi në shtëpi dhe bëri kontroll, nuk gjetën asgjë. Djali është kalama, është vetën 19 vjeç", -u shpreh gjyshi i Klevisit. Ndërkohë që makinat dhe shumica e eurove janë sekuestruar nga prokuroria për llogari të hetimeve. Por kjo histori po shoqërohet edhe nga një skandal politik, pasi katër ditë më parë, operacioni i Interpol u dekonspirua nga lideri i opozitës Lulzim Basha, që ka përdorur informacione tepër konfidenciale duke lajmëruar në sallën e Kuvendit operacionin.

ALBAN MOLLAYMERI

Gjithashtu, zbulohet roli i një prej katër të arrestuarve deri më tani nga Policia e Shtetit, shtetasi Alban Mollaymeri, 40 vjeç, lindur dhe banues në Tiranë. Mësohet se Mollaymeri është personi që kontraktoi transportuesit e makinave. Nuk dihet ende nëse Mollaymeri u porosit nga dy personat e shpallur në kërkim, por hetimet e mëtejshme të policisë pritet të hedhin në shumë dritë në këtë drejtim.

organizate kriminale, për trafik droge, dhe posedim pasurie me anë të veprave penale. Ndërsa 33-vjeçari Alfred Vladi është arrestuar në vitin 2008, pasi dyshohet se bënte pjesë në një grup kriminal që trafikonte makina të vjedhura nga

bëjnë me dije se mjetet "Toyota" "Yaris" ku u gjetën eurot ishin nisur Belgjika, kaluan transit në Itali dhe dy net më parë u nisën nga Ankona për në portin e Durrësit. Bllokimi i makinave është bërë menjëherë sapo ka zbritur nga trageji që vinte nga

REDAKSIA: Redaktor i Suplementeve dhe Sociale: Rezarta Delisula, Redaktor i Rrethëve: Trëndafilë VISHA, Redaktor i Kulturës: Fatmira Nikolli, Art Designer: Nevila SAMARXHI.

ADMINISTRATA: Përgjegjëse e Financës: Alma Smokthina 0682074397, Shpërndarja: Elvis Llaka Cel 0682074416, Marketingu: Cel:0682074415-email:marketing@gazetashqiptare.com, ADRESA: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autotrafektorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116 Marketingu: Tel:(04) 2359-104/359-123, Tiranë, Internet: www.balkanweb.com, Email: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, SHTYPUR në "Klasik"Shpk



Ina Allkanjari

Policia e Shtetit përmes një deklarate zyrtare ka dhënë ditën e djeshme detaje rreth operacionit në portin e Durrësit ku u sekuestruan 3.4 milionë euro. Zyrtarisht policia sqaroi se ka pasur dijeni nga burime vendase për karroatrecin që më datë 20 qershor, ndërsa shton se një agjenci ligjzbatuese shqiptare i ka njoftuar në orën 17:00 të datës 21, (pas deklarates së Bashës në Kuvend) për një ngarkesë me trajler që do të sillte disa mjete tip "Toyota", e cila pritej të vinte nga Gjermania, e mes tyre një mjet me sasi eurosh të padeklaruar. Mes të tjerash policia sqaron se në flagrancë janë arrestuar shtetasit; Agim Çeka, 61 vjeç, lindur në Luz i Madh, banues në Durrës; Edi Lika (Cani), 41 vjeç, lindur në Dibër, banues në Tiranë; Klevi Lika, 21 vjeç, lindur në Bulqizë, banues në Tiranë dhe Alban Mollaymeri, 40 vjeç, lindur dhe banues në Tiranë. Ndërkohë hetimet po vijojnë për zbardhjen e plotë të rrethanave të ngjarjes dhe zbulimin e personave të tjerë të implikuar.

NGARKESA

Ditën e enjte, 21 qershor 2018, në mesditë, gjatë punimeve të parlamentit në sallën e Kuvendit, është bërë publik fakti lidhur me një automjet tip "Toyota Yaris" me 1.5 milionë euro të zbuluar në Gjermani. Po atë ditë, të enjten e kaluar, datë 21 qershor 2018, një agjenci ligjzbatuese shqiptare në orën 17:00, ka njoftuar Policinë e Shtetit lidhur me një informacion për një ngarkesë me trajler që do të sillte disa mjete tip "Toyota", e cila pritej të vinte nga Gjermania, e mes tyre një mjet me sasi eurosh të padeklaruar.



KONTROLLET

Gjatë kontrollit të ushtruar në Pikën e Kalimit Kufitar Durrës në automjetin tip "Bizar" të drejtuar nga shtetasi Agim Çeku dhe pronar Klevi Lika (Cani), në 2 automjete të ngarkuara në të, tip "Toyota" është gjetur një shumë e konsiderueshme eurosh dhe franga zviceriane, të padeklaruar. Gjithashtu, janë ushtruar kontrole në banesat dhe ambiente të tjera të personave të dyshuar.

Operacioni në Durrës, emrat e 4 të arrestuarve dhe dy personave të shpallur në kërkim

3.4 milionë euro, policia: U njoftuam nga burime vendëse 5 ditë më parë

"Dy makinat 'Toyota Yaris' pritej të vinin nga Gjermania"



I arrestuari Alban Mollaymeri



Traileri që transportonte makinat

EMRAT

TË ARRESTUAR

- Agim Çeka 61 vjeç, lindur në Luz i Madh, banues në Durrës
- Edi Lika (Cani) 41 vjeç, lindur në Dibër, banues në Tiranë
- Klevi Lika 21 vjeç, lindur në Bulqizë, banues në Tiranë
- Alban Mollaymeri 40 vjeç, lindur dhe banues në Tiranë

TË SHPALLUR NË KËRKIM

- Alfred Vladi 33 vjeç, lindur në Peshkopi e banues në Tiranë
- Elvis Vladi 38 vjeç, lindur në Peshkopi e banues në Tiranë

SEKUESTRIMET

- 3,366,800 euro dhe 100 euro që dyshohet të jenë të falsifikuara
- 80,000 franga zvicerane
- 10 automjete, nga të cilat 7 automjete të tipit 'Toyota Yaris', 1 tip 'Alfa Romeo', 1 tip 'Opel' dhe 1 tip 'Bizar'
- 1 armë kallashnikov me 2 krehër fishekë, gjetur nga kontrolli i ushtruar në banesën e shtetasit Agim Çeka
- 1 radio policie
- 7 telefona celularë

NDALIMET

Në datë 24 qershor 2018, në Portin e Durrësit në orën 07:30, mbërriti nga Belgjika një trajler tip "Bizar" me 9 automjete, përmes Portit të Barit, Itali. Policia Kufitare, mbi bazën e porosisë së marrë në datë 20 qershor, ka bërë identifikimin dhe ndalimin e mjetit.

thit Gjyqësor Durrës, e cila po drejton hetimet. Më tej, specialistët për Hetimin e Krimeve në Drejtorinë Rajonale për Kufirin dhe Migracionin Durrës në bashkëpunim me efektivistët e Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës, nën drejtimin e prokurorisë, finalizuan operacionin dhe kryen veprimet procedurale. Policia ka arrestuar në flagrancë shtetasit: Agim Çeka, 61 vjeç, lindur në Luz i Madh, banues në Durrës; Edi Lika (Cani),

41 vjeç, lindur në Dibër, banues në Tiranë; Klevi Lika, 21 vjeç, lindur në Bulqizë, banues në Tiranë; Alban Mollaymeri, 40 vjeç, lindur dhe banues në Tiranë. Gjithashtu, janë shpallur në kërkim dhe punohet për kapjen e shtetasve: Alfred Vladi 33 vjeç, lindur në Peshkopi e banues në Tiranë; Elvis Vladi 38 vjeç, lindur në Peshkopi e banues në Tiranë.

Gjatë kontrollit të ushtruar në Pikën e Kalimit Kufitar Durrës në automje-

tin tip 'Bizar' të drejtuar nga shtetasi Agim Çeku dhe pronar Klevi Lika (Cani), në 2 automjete të ngarkuar në të, tip 'Toyota' janë gjetur një shumë e konsiderueshme eurosh dhe franga zvicerane, të padeklaruar. Gjithashtu, janë ushtruar kontrole në banesat dhe ambiente të tjera të personave të dyshuar. Janë sekuestruar në cilësinë e provave materiale: 3,366,800 euro dhe 100 euro që dyshohet të jenë të falsifikuara; 80,000 franga zvicer-

rane; 10 automjete, nga të cilat 7 automjete të tipit 'Toyota Yaris', 1 tip 'Alfa Romeo', 1 tip 'Opel' dhe 1 tip 'Bizar'; 1 armë kallashnikov me 2 krehër fishekë, gjetur nga kontrolli i ushtruar në banesën e shtetasit A.Çeka; 1 radio policie; 7 telefona celularë. Nga hetimet paraprake, Policia e Shtetit ka të dhëna të besueshme se ngarkesa e sekuestruar ishte e porositur nga shtetasit Elvis Vladi dhe Alfred Vladi, tashmë të shpallur në kërkim. Hetimet po vijojnë për zbardhjen e plotë të rrethanave të ngjarjes dhe zbulimin e personave të tjerë të implikuar. Materialet i kaluan Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës për veprat penale "Pastrimi i produkteve të veprtarisë kriminale ose veprtarisë kriminale e kryer në bashkëpunim", "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarakë dhe e municionit" dhe "Falsifikimi i monedhave".

TRAFIKU I DROGES REAGIMET

Hapja e negociatave, kreu i PD-së paralajmëron përgjigje negative nga Brukseli

Basha: Balla hyri garant, 3.4 mln euro të bandës së rrezikshme

"Paratë e krimit do përdoren për kullat"

Valentina Madani

Kreu i opozitës, Lulzim Basha akuzoi dje kreun e deputetëve socialistë, Taulant Balla për pastrim parash. Pak ditë pasi paralajmëroi nga seanca plenare se miliona euro po hynin kontrabandë në Shqipëri, Lulzim Basha deklaroi para mediave se shuma e sekuestruar në dy automjetet "Toyota Yaris" në portin e Durrësit i përket një prej bandave që vepron në zonën e Elbasanit dhe se garantuesi i parave është kreu i grupit parlamentar të socialistëve, Taulant Balla. Sipas tij, Balla u kishte siguruar hyrjen pa problem të kësaj shume në Shqipëri. "Paratë janë të një prej bandave më të rrezikshme të trafikut të drogës aktive kryesisht në Elbasan, por gjithë Shqipërinë. E dyta, Taulant Balla kishte marrëveshje për të garantuar hyrjen e këtyre parave pa problem në Shqipëri. 1.5 milionë ka qenë pakti dhe marrëveshja është garantuar nga Taulant Balla. Ky ka hyrë garant", theksoi z.Basha. Meritën për finalizimin me sukses të këtij operacioni ia njohu njërit prej vendeve partnere, që sipas tij është skeptik për hapjen e negociatave me Shqipërinë. "Policia shqiptare ka qenë nën presionin e një prej partnerëve tanë për të vepruar. Është një nga vendet partnere të cilat janë skeptike sa u përket kushteve të Shqipërisë për integrimin, veçanërisht luftën kundër krimit dhe korrupsionit. Është dekonspiruar plani i Taulant Ballës dhe strukturave brenda Policisë së Shtetit", u shpreh Lulzim Basha. Sipas kreut të demokratëve, destinacioni i parave do të ishte ndërtimi i kullave në kryeqytet, duke hedhur akuzë në adresë të kryeministrit dhe kryebashkiakut Veliqaj.

NEGOCIATAT
Kryedemokrati Lulzim Basha paralajmëroi përgjigje negative për negociatat me BE. Basha tha se përkundër dëshirës së shqiptarëve dhe përpjekjes së opozitës, Bash-



Kreu i opozitës, Lulzim Basha

LULZIM BASHA

"Balla merret me pastrimin e parave të drogës. Kanë kaluar te heroina e kokaina dhe pastrimi i parave të pista. 1.5 mln euro ka qenë pakti, marrëveshja është garantuar nga Balla, ky ka hyrë garant. Për këtë jam i siguruat, do ta vërtetojnë faktet. Ku do shkojnë këto para? Çfarë e lidh Tahirin, Xhafajn, Ballën, përveç Edi Ramës. Pastrimi i parave, ndërtimi i kullave", tha z.Basha.

"Toyota" me 3.4 milionë euro, PD akuzat të forta

Alibeaj, Ballës: Je garanti për hyrjen e tyre në Shqipëri

PD akuzoi dje Policinë e Shtetit se ishte në dijeni për makinën me 3.4 mln euro, që u kapën në Portin e Durrësit. Deputeti i PD-së, Enkelejd Alibeaj deklaroi: "Ky është bashkëpunimi më flagrant që një polici mund të bëjë me krimin e organizuar. Kjo konfirmon mbështetjen që trafiku i drogës ka këtu në Shqipëri. Objektivi i Policisë së Shtetit është mbrojtja e pushtetit kriminal. Lidhjet e Ramës me krimin u kanë mbyllur derën shqiptarëve në Europë. Me Edi Ramën kryeministër, ky vend nuk ka të ardhme". Sipas tij, Rama përdori Policinë e Shtetit për të fshehur të vërtetën e lidhjes së Ballës me milionat e eurove.



"Policia nuk është më në shërbim të qytetarëve, por ka si objektivi mbrojtjen e Edi Ramës. Po punon për të mbuluar lidhjet e Ramës me drogën. Pasi e vuri në shërbim të Tahirrit dhe për Xhafajn, e përdori për të fshehur lidhjet e Taulant Ballës për pastrimin e parave të Ballës.

Policia private gënjeh shqiptare për rrethanat. PD deklaroi me përgjegjësi se Balla ishte garanti për të hyrë këto para në Shqipëri dhe janë për një bandë që operon në Elbasan. E identifikuan ngarkesën pas presionit nga një anëtarët e BE-së", tha Alibeaj.

kimi European vendos këtë javë që Shqipëria nuk i ka plotësuar kushtet, sepse kushti themelor është të ndërtojë një shtet të së drejtës dhe jo një shtet të drogës, jo një narokshet. Kushti themelor është të ndërtojë një ekonomi me shanse të barabarta për të gjithë dhe jo një ekonomi të parave të pista të drogës, ku 5 banda kriminale dhe 5 oligarkë kontrollojnë të gjithë

ekonominë. Biznesi i vogël dhe i mesëm është në kolaps, profesionistët janë në arrati, mediat të kapura dhe rinia e pa-shpresë. Unë merrem me anën politike, e kuptoj dëshirën që të merrem dhe me anën policore dhe të prokurorisë, se policia dhe prokuroria kanë përfunduar ku kanë përfunduar; por këtë nuk mund ta bëj unë", deklaroi z.Basha.



Gjatë një seance parlamentare

ENDRIT BRAIMLLARI

LSI përmes deputetit Endrit Braimllari akuzoi dje kryeministrin dhe qeverinë e tij për pastrim parash. Ai iu referua sekuestrimit të rreth 3.4 milionë eurove. "Këto janë paratë e pista që ky kryeministër po përdor për të shkatërruar ekonominë, për të varfëruar shqiptarët dhe për të pasuruar veten e tij dhe bandën që e rrethon", tha ai.

Balla, Bashës: O Babale! E dhe shfaqjen e rënies së brekusheve

Kreu i grupit parlamentar të Partisë Socialiste, Taulant Balla iu kundërpërgjigji dje deklaratave të kryedemokratit Lulzim Basha, i cili e akuzonte si garant për kalimin e dy automjeteve me 3.4 milionë euro në portin e Durrësit. Me anë të një postimi në rrjetet sociale hodhi poshtë akuzat e kreut të PD-së. "O Babale! Mjerë kush të beson ty akoma dhe tak-sirati ynë që kemi përballë një opozitë që e ktheu në teatër babalesh! Je kaq i mbaruar o Babale sa tani nuk ke më këllqe as të sh-trëngosh iltastikum e brekusheve të rrenave, që të bien përditë në sy të miletit dhe ti hiç s'do me dit, po vazhdon si budallai i fshatit... Hajde Babale hajde, fli gjumë tani fli se për sot e dhe shfaqjen e rënies së brekusheve", shprehet z.Balla.



Paloka, Ballës: "Ballball"-ja zgjodhi të lëshojë gazra në 'FB'

Nënkryetari i PD-së, Edi Paloka dje reagoi pas prononcimit të kreut të grupit parlamentar të PS, Taulant Balla, i cili iu drejtua kreut të PD-së 'Babale' në lidhje me akuzat se ishte garant i 3,4 milionë eurove të sekuestruara në portin e Durrësit. Paloka e quan Ballën 'Ballballe' dhe shton se ai anuloi konferencën me gazetarët. "Jo Babale po Ballballe. Heshjtje që flet më shumë se gjithë diarreja orale e Ballës. Është akuzuar direkt që të enjten për një fakt që u konfirmua katërcipërisht, por heshiti. Ai që shefi i tij e përdor si letër higjienike, për të fshehur gjithë pislloqet që i plasim Ramës nga çdo kavitet i tij, sot që është i akuzuar direkt, in persona, heshiti. U fshih dhe pasi foli kryetari i opozitës. Gazetarët kanë qe dje që e kërkojnë. E kërkuan edhe sot. U premtoi se do të dilte me deklaratë nga PS pasi foli z.Basha, caktoi dhe orën, por e anuloi dhe në fund lëshoi vetëm gazra në faqen e 'FB', shprehet z.Paloka.



Partia Demokratike ka firmosur këtë muaj një kontratë të re lobimi në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Kryetari i PD, Lulzim Basha ka firmosur me kompaninë "Sonoran Policy Group" me qendër në Uashington. Ndërsa për kompaninë amerikane ka firmosur Christian Bourge. Kontrata e PD me "Sonoran Policy Group" është lidhur këtë muaj, më 12 qershor dhe është e vlefshme deri në 11 tetor 2018. Sipas pikave të kontratës, PD do t'i paguajë kompanisë amerikane 40.000 USD në muaj. Në kontratë parashikohet që kompania lobuese amerikane të organizojë takime mes përfaqësuesve të PD dhe kongresmenëve e autoriteteve të larta amerikane. Fokusi është promovimi i strategjisë së demokratëve në SHBA për luftën

"Sonoran Policy Group, LLC" iu afrua fushatës së Trump

PD firmos kontratë të re lobimi me një kompani në SHBA, do paguajë 40 mijë USD



Faksimile e kontratës së re të PD-së

kuara. Do të mundësohen takime me zyrtarët e administratës për angazhimin e klientit (Basha), Kongresit dhe ekzekutivit, si dhe çështjet ekonomike. Do të punojë me agjencitë e zbatimit të ligjit vendës dhe ndërkombehtar për të luftuar epideminë e krimit të organizuar, si dhe të kryejë çdo detyrë shtesë mbi një marrëveshje dhe rënë dakord", shkruhet ndër të tjera në kontratën e nënshkruar. "Sonoran Policy Group, LLC" është një kompani e vogël lobimi, e cila iu afrua fushatës së presidentit amerikan, Donald Trump përmes njohjeve me kongresmenët Dana Rohrabacher dhe M. Flynn.

kundër krimit të organizuar. Konsulentit do të punojë me opozitën shqiptare për të ndërtuar një strategji antinarkotike dhe

kundër krimit të organizuar për Shqipërinë. Marrëveshja do të lehtësojë takimet dhe bashkëpunimet me Shtetet e Bash-

Presidenti merr pjesë në paraqitjen e Indeksit të Paqes 2018: Qeveritë të flasin me gjuhën e paqes

Meta: Kriminaliteti i lartë sjell shpenzime për sigurinë

"Çmimi për të ruajtur paqen, më i vogël se pasojat e çdo konflikti dhe lufte"

Darina Tanushi



Presidenti i Republikës, Ilir Meta

Presidenti i Republikës, Ilir Meta deklaroi dhe se, "prania serioze e krimit të organizuar dhe korrupsionit në një vend do të thotë jo vetëm kërcënim i sigurisë, por edhe rritje të shpenzimeve për sigurinë e brendshme". Kjo, sipas kreut të shtetit, "heq mundësinë për të investuar në shumë fusha të tjera si edukimi, kultura apo infrastruktura, ku duhet të investojmë vazhdimisht në mënyrë që të garantojmë rritjen e qëndrueshme ekonomike dhe stabilitetin e vendit dhe kështu të forcojmë vazhdimisht paqen". Presidenti Meta i bëri këto deklaratat gjatë aktivitetit, ku u paraqiti raportin mbi Indeksin Botëror të Paqes 2018, një veprimtari e organizuar në Universitetin "Zoja e Këshillit të Mirë" nga Qendra Evropiane e Shkencës për Paqe, Integrim dhe Bashkëpunim (CES-PIC). "Siç e vërteton edhe studimi i paraqitur, një vend në paqe është një vend me një rritje ekonomike të qëndrueshme, të vazhdueshme, me mirëqenie të lartë dhe me rritje të të ardhurave për frymë të popullsisë. Nuk mjafton vetëm rritja e qëndrueshme ekonomike, por ajo duhet të jetë sa më gjithëpërfshirëse, pasi mirëqenia është garancia më e madhe e paqes, ndërsa

varfëria është një nga armiqet e paqes dhe pabarazisë ekonomike në rritje për-bën rrezikun më të madh për paqen në çdo vend dhe në çdo rajon", u shpreh presidenti. Sipas tij, "besimet fetare kontribuojnë në ndërtimin e paqes, duke ndikuar në klimën morale-shoqërore-politike, përmes forcimit të frymës së bashkëpunimit mes komuniteteve të ndryshme". "Konfliktet e ashtuquajtura fetare sot në botë, siç e dini shumë mirë edhe nga konfliktet jo të largëta në kohë në rajonin tonë, nuk janë konflikte të besimeve, por konflikte, të cilat keqpërdorin një besim të caktuar për të arritur

qëllime politike, hegjemoniste apo ekonomike. Asnjë fe e madhe nuk predikon pjesëmarrje dhe nuk është burim i konfliktit, por secila prej tyre është një forcë në krijimin e paqes", u shpreh Meta. Sipas presidentit, "Shqipëria për fat të mirë mbetet dhe është e vendosur të vazhdojë të jetë model i paqes dhe i harmonisë mes komuniteteve fetare. Ne jemi shumë krenarë që kjo vlerë historike dhe kombëtare ruhet dhe forcohet larg influencave dhe tendencave të huaja për to dhe për popullin tonë. Evropa dhe bota sot po përjetojnë ringjalljen dhe rritjen e rrymave populiste, nacionaliste dhe ekstrem-

iste në disa vende, të cilat jo vetëm shfaqen kundër projektit evropian të paqes dhe solidaritetit të pas Luftës së Dytë Botërore, por mbështesin me nostalgji ringjalljen e koncepteve të shtetit-komb dhe hegjemonizmit nacionalist, etnik apo dhe fetar, të cilat ishin burimi i lindjes së konflikteve botërore. Përballë kësaj situatë, qeveritë, shoqëria civile, intelektualët e përfaqësues të të gjitha kombeve duhet të bëhen bashkë e të flasin me gjuhën e paqes dhe të veprojnë të gjithë me një mision të përbashkët. Kjo është një sfidë dhe një apel për të kuptuar se çmimi për të ruajtur paqen është shumë herë më i vogël se sa pasojat e çdo konflikti dhe lufte", theksoi presidenti. "Shpresojmë që ky të jetë një vit i mbarë jo vetëm për Shqipërinë, por për të gjithë rajonin! Kemi një moment mjaft pozitiv, sikurse është marrëveshja me Maqedoninë dhe Greqinë për zgjidhjen e çështjes së emrit dhe do të ketë një impakt të madh për të gjithë rajonin, për Maqedoninë dhe vendet tona. Shpresojmë që dialogu Serbi-Kosovë të japë një impakt pozitiv për të gjithë rajonin tonë dhe të rritet besueshmëria e tij. Që paqja të jetë edhe më e qëndrueshme se sa deri më tani, edhe që të jetë edhe më pozitive se deri tani!", u shpreh presidenti.

Kapja e 3.4 mln lekëve në port, debate të ashpra PS-PD në Kuvend

Kapja e 3.4 mln lekëve në portin e Durrësit u shndërrua në debat të ashpër në Komisionin parlamentar të Shëndetësisë mes mazhorancës dhe opozitës. Në Komisionin e Shëndetësisë, rendi i ditës ishte për disa ndryshime në ligjin ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare, por debati politik u dominua nga çështja e kapjes së 3.4 mln euro në Portin e Durrësit. Opozita në komisionin parlamentar tha se Edi Lika, pronari i trailerit i arrestuar nga policia, është dënua nga Gjykata e Apelit me 6 muaj burg për dhunë në familje dhe nëse ai do të kryente burgun, nuk do të përdorej për trafik droge. Në cilësinë e kryetares së komisionit pasi Petrit Vasili mungoi, Elisa Spiropali kërkoi që faktet të denoncohen në prokurori. Deputeti i PD-së, Ervin Salianji tha: "Policia e ka kapur vetëm për një arsye, të mos shkojë hetimi deri në fund dhe të mos zbulohet kreu i grupit të strukturuar kriminal. Edi Lika, i dënua për dhunë në familje. Në vend ta kishe në burg për dhunë në familje, ti e përdor për drogë". Deputeti tjetër i PD-së, Bardh Spahia iu tha deputetëve të PS-së: "Qeshët të gjithë juve kur u denonca në seancë plenare, më shumë qeshi pronari i 'Toyota Yaris', kreu i grupit tuaj parlamentar". Komisioni nuk mund të kishte një ecuri normale diskutimi, përplasjet verbale mazhorancë-opozitë vijuan me tone të ashpra. Mbledhja u ndërpre dhe në rikthim të diskutimit, Spiropali tha se sjellja e deputetëve kërkon ndjesë publike.

Njoftim për shitje ankand II

Sh "Power & Justice" (P&J) sh.p.k do të zhvillojë ankandin e dytë për pasurinë e Hipotekuesit A Milia. Pasuria që shitet në ankand përbehet nga:

- "Aparamenti" me numur pasurie 1/126+1-4 Zone Kadastrale 8170 Volumes 1, Fage 154, me sipërfaqe 75.1 m² në adresën Rr "Q Stala" pall 8, shk 1, kati dyte, Ap 4 Tiranë
- Ankandi i pasurisë fiton me çmimin më të ulët në masën 30 përqind të ankandit të parë.

Ankandi do të zhvillohet 13.07.2018 në orën 15:00 në selinë Bulev "G.Fishat" Kulla 1, Kati 2, Zyra nr. 5. Kontakti tel: 672082543 e-mailit ilir_dervishaj@yahoo.com si dhe [WEB www.powerjustice-si.com](http://www.powerjustice-si.com).

NEGOCIATAT ME BE REAGIMET

Negotiatat me Shqipërinë, vendos sot Këshilli i Punëve të Përgjithshme në BE

Çështja çame, Kotzias: Nuk kemi diskutuar për këtë në negociatata

"Vorio-Epiri, pjesë e Shqipërisë, nuk ndryshojmë kufijtë"

Darina Tanushi

Ministri i Jashtëm grek, Nikos Kotzias u bëri thirrje vendeve të Bashkimit Evropian që të hapin negociatat me Shqipërinë. Me nismë të ministrit grek të Punëve të Jashtme u mbledhën dje në Luksemburg grupi "Miqte e Shqipërisë" në Këshillin e ministrave të Jashtëm të BE-së. Në takim morën pjesë ministrat e Punëve të Jashtme të Gjermanisë, Italisë, Austrisë, Suedisë, Rumanisë, Polonisë, Bullgarisë, Maltës, Qipros si dhe vende të tjera anëtare të BE-së dhe Përfaqësuesja e Lartë për Politikën e Jashtëm të BE-së, Federica Mogherini. Në një intervistë për "euroactive", Kotzias tha: "Sipas mendimit tonë, që kur Komisioni Europian caktoi këtë verë vizionin për të filluar negociatat formale me Maqedoninë dhe Shqipërinë, ne na duhet ta mbajmë premtimin që bëmë. Unë do të doja t'u bëja një apel të gjitha palëve për të kuptuar se me këto vende ka me të vërtetë probleme. Ne i kemi vënë ato në radhë të parë, por duke bashkuar me një proces monitorimi dhe shqyrtimi, ata mund t'i zgjidhin ato në mënyrë më efektive", deklaroi ai. "Unë u kam thënë homologëve të mi se ata mund të jenë aq të rreptë sa të duan, por ne nuk duhet ta bllokojmë atë perspektivë. Kam frikë se nëse Maqedonisë nuk i jepet një datë për pranim, të gjitha këto përpjekje që kemi bërë me sakrificë dhe kompromise të mëdha nga të dyja palët, mund të vihen në rrezik. Për më tepër, nëse një nga dy vendet fillon negociatat, dhe le të themi, Shqipëria lihet jashtë, kjo do të krijojë një gjendje paqëndrueshmërie në rajon", - theksoi ministri grek. Greqia është mike e të gjitha vendeve të Ballkanit, vijoi Kotzias duke shtuar se, "kemi një miqësi të madhe tradicionale me Serbinë, por me të vërtetë pyes veten: për sa kohë do të qëndrojë Shqipëria duke parë Serbinë të ecë, përshpejtojë dhe përfundojë negociatat, ndërsa Tirana nuk i ka filluar fare? Këto janë faktorë destabilizues, sepse qeveritë nuk do të arrijnë t'i mbijetojnë. Dhe ndryshimet në rajonin e Ballkanit, përveç Greqisë, nuk kanë qenë kurrë të lehta apo të këndshme". Në lidhje me çështjen çame, Kotzias tha: "Ne nuk e diskutojmë fare këtë. Në këtë debat (negociatat) nuk ka pasur asnjëherë pyetje për Çamërinë. Na akuzojmë madje se po dorëzojmë Vorio-Epirin. Nëse nuk e kanë kuptuar me



traktatet ndërkombëtare dhe Aktin Final të Helsinkit, Vorio-Epiri është pjesë e Shqipërisë dhe ne nuk kemi aspak ndërmend të ndryshojmë kufijtë. Këto janë psikozat që janë të këqija në vend dhe nuk kanë të bëjnë aspak me politikën evropiane të dialogut dhe kompromisit".

VENDIMI

Nëderkohë, pritet që Shqipëria të mësojë sot fatin e negociatave të anëtarësisit

në Bashkimin Evropian. Në mbledhjen e Këshillit të Punëve të Përgjithshme, pjesë e Bashkimit Evropian, do të diskutohet sot mbi mundësinë e zgjerimit të mëtejshëm të Bashkimit Evropian dhe mbi kërkesën e Komisionit Evropian për të hapur negociatat me Shqipërinë dhe Maqedoninë. Në përgjigje të kërkesës së "Ora News", zëdhënësi i Këshillit Evropian tha se çështja e zgjerimit diskutohet

EDI RAMA

"Samiti i BE-së për krizën e refugjatëve shpoi tullumbacen gjigante të lajmit të rremë për kampin në Shqipëri! Ky lajm i prodhuar dhe propaganduar nga esadistët e rinj të Shqipërisë në politikë e media, s'ka asnjë lidhje me planet e BE-së për refugjatët. Mos t'ua harrojmë këtë turp", shkroi dje kryeministri Rama, duke hedhur poshtë zërat për 600 mijë sirianë.

het pikërisht sot nga Këshilli i Punëve të Përgjithshme të Bashkimit Evropian, ndërsa përfundimet e kësaj mbledhjeje mund të mbëshiten ose jo në mbledhjen e liderëve në datën 28 dhe 29 qershor Pra, çështja e negociatave do të diskutohet vetëm ditën e nesërme dhe do t'i paraqitet për miratim Këshillit në 28 qershor. Në mbledhjen e Këshillit të datës 28-29 qershor do të diskutohet mbi 3 tema kryesore, të cilat janë emigracioni, politikë e sigurisë dhe mbrojtjes si dhe çështjet ekonomike dhe financiare. Gjithashtu, liderët e BE-së do të adresojnë edhe çështjen e BREXIT dhe eurozonës.



"Tsipras e Rama do firmosin paktin e partneritetit"

Bushati për "To Vima": Çështja çame ka të bëjë me të drejta themelore të njeriut

Ministri për Europën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati konfirmoi dje se Shqipëria dhe Greqia janë shumë pranë marrëveshjes për detin dhe se është planifikuar vizita e kryeministrit grek në Tiranë. Dy shefat e qeverive, Rama dhe Tsipras do të nënshkruajnë paktin e partneritetit strategjik. Deklaratat Bushati i ka bërë gjatë intervistës për gazetën greke "To Vima". "Dy kryeministrat pritet të nënshkruajnë një Deklaratë të Partneritetit Strategjik gjatë vizitës së planifikuar të z.Tsipras në Tiranë", u shpreh Bushati. I pyetur për çështjen çame, ministri Bushati nuk e ka fshehur faktin se të dyja vendet kanë pikëpamje dhe qëndrime të ndryshme mbi këtë temë. "Nuk është sekret se kemi pikëpamje të ndryshme me Greqinë se si e shohim çështjen e çameve. Kjo është një çështje e përfshirë në programin politik të qeverisë shqiptare që nga viti 2013, pas një rezolute unanime nga parlamenti. Prandaj, në çdo rast dhe brenda këtyre bisedimeve paraqesim pikëpamjet tona për këtë. Kryeministri Rama është përgjigjur në mënyrë të përsëritur për mediat greke dhe unë gjithashtu si një çështje e të drejtave themelore të njeriut dhe lirive në shekullin e 21-të. Kjo lidhet me të drejtat e lëvizjes së lirë, pasurisë, kujtesës dhe respektit për paraardhësit. Është gjithashtu një çështje e përgjegjësisë personale dhe jo e dënimit kolektiv. Ne kemi deklaruar qartë se Shqipëria është plotësisht e angazhuar për të respektuar Kartën e OKB-së, Aktin Final të Helsinkit dhe Protokollin e Firences, në paprekshmëri dhe kufijve dhe integritetit territorial. Shqipëria dhe Greqia janë anëtare të Këshillit të Europës dhe janë të detyruara të zbatojnë ligjin dhe parimet kryesore në fushën e pronës dhe të drejtës e lëvizjes, që rrjedhin nga Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut".



PDIU e shoqata "Çamëria" kërkojnë shpjegime nga Bushati e Kotzias

"Do t'u bëjmë thirrje shqiptarëve të bojkotojnë produktet greke"

Pas deklaratës së ministrit të Jashtëm grek se nuk ka pasur diskutime për çështjen çame gjatë negociatave me Shqipërinë, PDIU dhe shoqata "Çamëria" deklaruan se do t'u bëjnë thirrje shqiptarëve të protestojnë. "Ne do t'u bëjmë thirrje shqiptarëve të bëhen pjesë e një proteste civile, e që në fillim të bojkotojnë produktet greke në treg dhe bankat greke si hapin e parë, por që më pas do të ketë shumë forma të tjera më të ashpra e radikale", thuhet në deklaratën e çameve. "Kjo mospërfshirje e çështjes çame kërkon shpjegime dhe reagim të menjëhershëm nga qeveria shqiptare dhe Ministria e Jashtme, sepse bëhet fjalë jo vetëm për një



çështje kombëtare e menjëhershme të lartë për të gjithë shqiptarët, po në veçanti për një kauzë njerëzore, e cila prek qindra-mijëra familje, viktimat të gjencoidit", thuhet në deklaratë. "Ne kërkojmë që z.Bushati të

plotësojë me përgjegjëshmëri kushtetuese e njerëzore detyrimet e tij. Shoqata 'Çamëria' e PDIU është e gatshme ta asistojë e të jetë pjesë e këtyre bisedimeve, por deklarimi se pala greke nuk pranon bisedimet është justifikim i pamoralshëm e tradhti e çështjes kombëtare", shprehen çamët. "Ftojme z.Kotzias të jetë i kujdesshëm në deklarimet e tij e mos të jetë i vetëkënaqur sepse çështjen çame, çamët, të vrrarët, gjykatat ndërkombëtare, por edhe gjyqin e historisë do t'i ketë përballë gjithmonë, e duhet ta ketë fort të qartë, se jo gjithmonë do të ketë përballë shtetarë servilë e të intimiduar që tjetër thonë në Tiranë, e tjetër në Athinë".

SHPLLALJE ANKANDI
Zyra Përmbarimore "E.G Bailiff Service" me përbarues Enuar Merko me adresë Rr Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tiranë, njofton se me datë 03.07.2018 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi i l për shlyerjen e pasurisë të palajftshme Truall me sipërfaqe totale 500 m² nga e cila Ndërtësi me sipërfaqe 128 m², regjistruar në Z.V.R.P.P Durres me Nr pasurisë 72/67, Vol.3, Fq.189, ZK 1242 në pronësi të Z.Sali Ibrahim Jamaku me vlerë fillestare në ankan 128.640 (Njëqind e njëzet e tetë mijë e gjashtëqind e dyzet) EURO . Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, 350 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com



TRITAN SHEHU

Deputeti i PD, Tritan Shehu, gjatë një vizite në Strasburg, takoi presidentin e Komisionit Europian, Z. Juncker. Shehu shkruan se "përpjekjet tona janë koncentruar në një pikë, në arritjen e hapjes së negociatave për anëtarësimin e vendit tonë në BE".



Vlahutin: BE, kusht për Shqipërinë reformat, jo refugjatët, nuk do ketë kamp

Ambasadorja e BE, Romana Vlahutin nga Malësia e Madhe bëri dje të qartë se në Shqipëri nuk do të ndërtohet asnjë kamp refugjatësh. Sipas saj, kushti i vendosur nga BE për Shqipërinë janë reformat dhe jo refugjatët për të hapur negociatat. Ambasadorja e Bashkimit Evropian në Tiranë, Romana Vlahutin komenton sërish çështjen më të përfolur të momentit dhe tha se nuk ka asnjë plan për kamp refugjatësh në Shqipëri. Vlahutin sqaroi ndër të tjera se hapja e negociatave s'mund të kushtëzohet me pranimin e refugjatëve. Ambasadorja gjithashtu deklaroi se të vetmet kushte që mund të jenë, kanë të bëjnë me një mirëqeverisje dhe përmirësim të situatës në Shqipëri. "Në kuptimin e kampionit jo, absolutisht jo! Kjo është hera e pestë që i jap përgjigje kësaj pyetjeje javën e fundit dhe jam përgjigjur gjithmonë thjesht dhe qartë, jo! Jo, nuk ka asnjë plan dhe asnjë lloj përpjekjeje të tillë për të 'shkëmbyer' me një kusht të tillë. Nëse ka kushte, janë kushte për më mirë për Shqipërinë. Gjithçka që mund të bëjë është me shtetin e së drejtës dhe mirëqeverisjen dhe jo me një plan refugjatësh", tha Vlahutin. E pyetur për vendet skeptike, Vlahutin tha se ajo nuk ka lobjuar për Shqipërinë në BE, por punon me Shqipërinë për integrimin.

SHPALLJE ANKANDI
Datë 02.07.2018, Ora 16:00

Shoqëria Përmirëimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë Rr. "George W. Bush", Pallati "Kasmi", Zyra 107, Tiranë. Tel. 404506426, Cel. 067 201 9460/068 904 9202, e-mail: besnik.bajraktari@gmail.com. Shpall ankandin e parë për pasurinë e paluajtshme të debitorit Shoqëria "VIGAND Konstruksion" sh.p.k. "Njësi" me sipërfaqe 265, 22 m2, nr. i pasurisë 8/440-N12, zona kadastrale 8150, vol. 47, faqe 208, adresa: Rruga "Petro Nini Luarasi", Tiranë. Çmimi fillestar i ankandit të dytë është në shumën 339.482 (treqind e shtidhjetë e nëntë mijë e katërqind e tetëdhjetë e dy) EUR. Ankandi do të zhvillohet në ambientet e Shoqërisë Përmirëimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë: Rr. "George W. Bush", Pall. Kasmi, Zyra 107, Tiranë.

Deputeti gjerman, Wadephul: Po shpenzojmë shumë energji që të bindim miqtë tanë francezë

Gjermania përpriqet të bindë Francën për Shqipërinë

"T'i harrojmë kritikak që kemi për Shqipërinë"

Deputeti gjerman i CDU-së, Johann Wadephul shprehet për "Deutsche Welle"-n, se Gjermania po përpriqet të bindë Francën për të dhënë dritën e gjelbër për çeljen e negociatave me Shqipërinë. Nëse Gjermania ka një qëndrim pozitiv për hapjen e negociatave të anëtarësimit të Bashkimit Europian me Shqipërinë, Franca është vendi që ka dyshime për këtë hap, krahas Holandës. Bundestagu pritet të konfirmojë të enjten çeljen e negociatave me Shqipërinë pas rekomandimit pozitiv për negociatat të grupit parlamentar konservator, CDU/CSU të shoqëruar me kushte. Por, qëndrimi i Francës mbetet skeptik. Presidenti i Francës, Emmanuel Macron kërkon që BE të reformohet më parë, pastaj të merrret me zgjerimin. Por pala gjermane nuk është e këtij mendimi. Deputeti gjerman i CDU-së, Johann Wadephul është shprehur për "Deutsche Welle"-n, se Gjermania po punon për të bindur Francën në këtë drejtim. "Ne po shpenzojmë shumë energji që të bindim miqtë tanë francezë që të hapen negociatat e anëtarësimit me Shqipërinë", tha Wadephul. Deputeti konservator gjerman thekson se, "me gjithë vërejtjet kritike që kam bërë për Shqipërinë, dua të them në veçanti, se ne gjermanët dhe fraksioni i CDU/CSU-së gëzohejmë që kemi kontakte miqësore me Shqipërinë, që Shqipëria është një vend mjaft miqësor ndaj Europës dhe ne duam që ta shoqërojmë pozitivisht në rrugën drejt Europës. Kjo nuk do të thotë që i harrojmë kritikak që kemi". Edhe eurodeputeti gjerman, socialdemokrati Knut Fleckenstein nuk e përkrash qëndrimin pritis francez për negociatat. Ai i tha "Deutsche Welle"-s, se Franca ka rezerva, por "mendoj se ky është një argument i gabuar, sepse negociatat nuk zgjasin disa ditë, por me vite dhe në këtë kohë mund të kryhen reformat tona të nevojshme për të pranuar vende të tjera".

VENDIMI

Bundestagu gjerman vendosi një "Po" të kushtëzuar për hapjen e negociatave me Shqipërinë, i ndikuar nga reforma zgjedhore dhe procesi i vetingut. Në takimin e zhvilluar për një qeverisje të



Deputeti gjerman i CDU-së, Johann Wadephul

KE kërkon hapje të negociatave për Shqipërinë

Mogherini: Ballkani bëri progres, Shqipëria meriton hapjen e negociatave

28 ambasadorët e përhershëm të Bashkimit Europian janë mbledhur në Luksemburg për të rishikuar qëndrimin për hapjen e negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë dhe Maqedonisë. Teksa Maqedonisë pritet t'i jepet drita jeshile, por me disa kushtëzime, për Shqipërinë situata paraqitet më e komplikuar. Qëndrimi i parlamentit të Holandës i ka detyruar shtetet anëtare dhe presidentin bullgar të angazhohen në negociatat, për të evituar një skenar negativ për Shqipërinë. Ambasadori francez ka treguar se Franca mbetet rreptësisht kundër, ndërsa ambasadori holandez nuk e ka marrë fjalën, duke lënë të kuptohet se pozicioni i vendit të tij është i qartë dhe nuk mund të neglizhohet. Nga ana tjetër, përfaqësuesja e lartë e Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së BE-së, Federica Mogherini dha sërish dje një sinjal inkurajimi për dy të vendet para takimit të ministrave të Jashtëm të BE. "Rekomandimi i KE është hapje e negociatave të anëtarësimit me Shqipërinë dhe me Tiranën. Ky proces është i bazuar në meritë, që do të thotë që kur ka progres, ky progres duhet të njihet dhe të inkurajohet. Shpresoj që shtetet anëtare të marrin vendimin e duhur. Ne shohim progres impresionues në Ballkan. U njoftuam me nënshkrimin e marrëveshjes për emrin e Maqedonisë 10 ditë më parë. Është një moment historik, që duhet mbështetur. Tani Bashkimi Europian duhet të jetë konsistent me qëndrimin e tij", -deklarozi Mogherini.



PETRIT VASILI

"Po si mundet të besohet Vlahutin kur flet për refugjatët? Pse nuk hesht xhanëm?! Vlahutin foli nga Shkodra për refugjatët. Gjithmonë ajo flet pasi flet Edi Rama dhe gjithmonë thotë të njëjtat gjëra si ai. Kush e beson? Askush. Gjermania thotë me gojë plot na i kërkuan vetë shqiptarët refugjatët. Vlahutin thotë jo. Deklarimet për refugjatët vijnë nga të katërta anët, nga Brukseli nga Franca etj., etj., Vlahutin prapë thotë jo. Kryeministri bullgar flet për ish-at e ISIS, ndërsa Vlahutin thotë jo. Pse nuk hesht xhanëm!?", deklaroi kreu i deputetëve të LSI.



mirë, drejtori i fondacionit "Konrad Adenauer", Walter Glos tha se për këto dy procese ka ende rezerva. Ai nënvizoi se skepticizimi shtohet edhe pas vendimit të parlamentit të Holandës. "Bundestagu gjerman dha një 'Po' të kushtëzuar për Shqipërinë. Procesi do të jetë i lidhur ngushtë me reformën zgjedhore për gjyqtarët dhe

prokurorët. Edhe pse reforma zgjedhore dhe ajo në drejtësi po ecin, ne kemi rezerva. Jemi skeptikë për hapjen e negociatave, sepse nga Holanda nuk po vijnë lajme pozitive", tha Walter Glos. Ai bëri me dije se Gjermania po jep kontribut për reformën zgjedhore, për të cilën pritet një draft përfundimtar në vjeshtë. "Reforma zgjedhore

është e këndësishme për ne, pasi kemi kontribuar dhe vazhdojmë të japim eksperiencë. Uroj që në vjeshtë të kemi një draft përfundimtar", deklaroi Z. Glos. Drejtori i fondacionit "Konrad Adenauer" tha se për Maqedoninë, vendimi i Bundestagut për hapjen e negociatave ishte i lehtësuar, pasi kushtet në këtë rast ndryshojnë.

Konferenca "Borxhi publik dhe efektet e tij në ekonomi"

Civici: Çdo shqiptar lind me një borxh prej 3 mijë euro

Niveli i borxhit publik në Shqipëri mbetet një rrezik për ekonominë. Ekspertët thonë se Shqipëria renditet në listën e vendeve problematike pasi borxhi nuk përdoret për të stimuluar rritjen ekonomike, por për të mbuluar gropat në të ardhurat buxhetore. Çdo shqiptar sot ka rreth 3 mijë euro borxh që në momentin që vjen në jetë. Pjesëmarrës në konferencën "Borxhi publik dhe efektet e tij në ekonomi", ekspertët e ekonomisë, vlerësojnë se borxhi publik në Shqipëri është në nivel të lartë rreth 65.8, dhe më i larti në rajon. Të dhënat u bënë të ditura në konfer-

encën "Borxhi publik dhe efektet e tij në ekonominë e Shqipërisë". Pavarësisht nismës së qeverisë për uljen e borxhit publik përsëri ai mbetet një shqetësim për ekonominë. Institucionet ndërkombëtare financiare dhe ekspertët e vlerësojnë me risk pasi vendi ynë nuk e përdor borxhin publik për investime, por për të mbuluar gropat e të ardhurave në buxhet. Eksperti Ardian

Civici thotë se çdo shqiptar që lind aktualisht ka 3 mijë euro borxh, ndërsa e cilëson të vështirë sfidën për të ulur borxhin nën 60%. "Çdo shqiptar sot ka aktualisht rreth 3 mijë euro që kur lind. Pra, relativisht në raport me numrin e popullsisë, por edhe krahasuar me vendet e rajonit jemi vendi me nivelin më të lartë të borxhit, qoftë në raportin me PBB, qoftë në raport me këtë detyrim që

përmenda për çdo individ", tha Civici. Eksperti Arben Malaj ish-ministër i financave e lidh nivelin e borxhit publik me politikëbërjen. Malaj sygjeron që miratimi i buxhetit dhe i borxhit publik në parlament të bëhet me shumicë të cilësuar. "Në këtë aspekt unë mendoj që politikë fiskale duhet të jenë të kujdesshme, nuk duhet të ndryshojnë shpesh. Rritja e të ardhurave duhet të vijë



nga përmirësimi i administrimit, i cili duhet të vijë me reforma, jo me veprime arbitrare. Por, ne nuk arritëm të kemi ligjin organik të buxhetit me shumicë të cilësuar. Ligji aktual i buxhetit është me shumicë të thjeshtë,

mund të jetë një moment që të kalojë me shumicë të cilësuar", tha Malaj. Aktualisht Shqipëria e ka nivelin e borxhit publik 68.6% ndërsa synon që deri në fund të këtij mandati niveli i borxhit publik të arrijë nën 60%.

Vijon aksioni në zonat turistike, do të kalojnë në ditë 20 mijë subjekte

Vasilika Vjero: Bizneset me shkelje, mbyllje aktiviteti 30 ditë

Drejtoresha e Përgjithshme e Tatimeve: Zero tolerancë

Ornela Manjani

Bizneset në zonat turistike që shkelin ligjin, duke fshehur të ardhurat apo duke mos deklaruar punonjësit, rrezikojnë mbyllje të aktivitetit për një periudhë 30 ditore në kulmin e sezonit. Drejtoresha e Përgjithshme e Tatimeve, Vasilika Vjero, ka theksuar se administratat tatimore do të ketë zero tolerancë ndaj subjekteve që zhvillojnë aktivitet në kundërshtim me ligjin. Vjero bëri me dije se për bizneset e rregullta do të ketë reduktim kontrollësh, ndërsa për ato që ka të dhëna se janë problematike, do të ketë shtim të kontroleve. Në të gjithë vijën bregdetare do të kontrollohen 20 mijë biznese.

AKSIONI

Një pjesë e subjekteve që ushtrojnë aktivitetin e tyre në zonat bregdetare, vijnë në punojnë në mënyrë të paligjshme, duke mos u regjistruar në organet tatimore, duke mos regjistruar punonjësit si dhe mos lëshuar kuponin tatimor. Fakti është bërë publik nga drejtoresha e Përgjithshme e Tatimeve, Vasilika Vjero, e cila ka deklaruar, se administratat tatimore do të ketë tolerancë zero ndaj tyre, duke u mbyllur, gjobitur dhe kallëzuar penalisht për aktivitetin që ata kryejnë. "Dëshirojmë t'u drejtohem publikisht këtyre sipërmarrjeve për t'u thënë se nuk do të ketë asnjë tolerancë nga administrata tatimore në funksion të zbatimit të ligjshmërisë së këtyre bizneseve deri në mbyllje të aktiviteve të tyre për një periudhë 30 ditore çka do të dëmtonte realisht aktivitetin e tyre. Sigurisht që ne nuk e dëshirojmë një gjë të tillë, por përpara ligjit janë të gjithë të barabartë. Ndaj zero tolerancë për këdo që mendon se mund të ushtrojë aktivitet të paligjshëm apo mendon se mund t'u devijojë detyrime ligjore", tha Vjero. Vjero nënvizoi faktin, se gjatë sezonit turistik, shumë biznese kryesisht në zonat bregdetare, riaktivizohen dhe intensifikojnë veprim-



Drejtoresha e Përgjithshme e Tatimeve, Vasilika Vjero

tarinë e tyre, në funksion të fluksit të qytetarëve. Sipas saj, kjo ka bërë që administratat tatimore të jetë gjatë gjithë kohës në terren, për të parandaluar subjektet e tilla që të ushtrojnë aktivitetin e tyre, duke qenë se janë tërësisht jashtë kontrollit të in-

stitucioneve. "Ne, gjejmë rastin të falenderojmë të gjithë ata tatimpagues, të cilët iu përgjigjen pozitivisht thirrjes sonë për t'u vetëkorrigjuar dhe për të vetëdeklaruar detyrimet e tyre. Kjo do të thotë deklarim i xhiros reale, pra si rrjedhim xhiro më e

lartë, përdorim i kuponit tatimor; faturim i ndershëm. Të gjitha këto në funksion të nxitjes së konkurrencës së ndershme, regjistrim të numrit të të punësuarve dhe të pagesave të kontributeve për ta. Ndaj për këto sipërmarrje, të cilat tregojnë përgjegjshmëri në ushtrim e aktivitetit të tyre administrativ tatimor do të vijojë të ketë një qasje shumë pozitive, duke reduktuar kontrollin tatimor për sa kohë ata do të vijnë në vetëdeklarim dhe paguan rregullisht detyrimet. E kundërta do të ndodhë me ata tatimpagues, të cilët kërkojnë t'i fshihen administratës tatimore, duke krijuar së pari, një pandershmëri në konkurrencë e së dyti, duke shmagur detyrimet ligjore", tha Vjero. Drejtoresha e Përgjithshme e Tatimeve, ftoi të gjithë qytetarët që të bashkëpunojnë në luftën kundër informalitetit, duke refuzuar pagesat nëse nuk iu jepet kuponin tatimor. Gjithashtu, çdo i punësuar mund të denoncojë raste të mospagesave të kontributeve për punën e kryer.

Frutat dhe perimet, ndër dhjetë artikujt më të importuar në janar-mars

Frutat dhe perimet u klasifikuan nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave si një ndër 10 mallrat më të importuar në vend gjatë tremujorit të parë të vitit 2018. Sipas të dhënave zyrtare, frutat dhe perimet u renditën të nëntat në radhë në listën e 20 mallrave të importuara nga jashtë. Nga zhdoganimi i tyre, doganat kanë arkëtuar 738 milionë lekë të ardhura 5,5 milionë euro. Edhe pse prodhimet e frutave dhe perimeve në vend po vijnë në rritje, ato nuk po plotësojnë ende hendekun në tregun vendas dhe sidomos në prodhimin vendas. Deficiti në tregtinë me jashtë të fruta-perimeve zakonisht është i lartë në tremujorin e parë të çdo viti për shkak se ende nuk kanë dalë në treg prodhimet e stinës, shuka shihet se importet në këtë periudhë vijnë nga vendet mesdhetare të tilla si Greqia dhe Italia. Më 2017, për herë të parë që nga liberalizimi i tregtisë me jashtë, eksportet e fruta-perimeve ishin 14% më të larta se importet e këtij grupi. Sipas INSTAT, eksportet e frutave dhe zarzavateve arritën në 9.6 miliardë lekë me një rritje 21% nga viti 2016. Ndërsa importet arritën në 8.3 miliardë lekë me një rritje prej 0.2% kundrejt vitit 2016. Si importet dhe eksportet kanë ardhur në rritje që nga viti 2012, por shifrat jashtë vendit janë rritur me ritme më të shpejta. Produkti më i importuar në tremujorin e parë ishin karburantet, të cilat kontribuan me 8.4 miliardë lekë taksa në arkën e doganave ose në 23 për qind të të ardhurave doganore.

Peeshi në Korçë: Investoni në agroturizëm, ka lehtësira fiskale

Agroturizmi tani trajtohet si një hotel me 5 yje, në kuptimin e lehtësirave fiskale". Kështu ka deklaruar ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Niko Peeshi nga fshati Vresh-tas, në qarkun e Korçës. Në fjalën e tij ministri Peeshi ka nxitur fshatarët e kësaj zone, por dhe të gjithë banorët e zonave rurale me potenciale turizmi, të investojnë në këtë sektor të ri, që është agroturizmi, që



sipas ministrit është kthyer sot në një nga "trendet e zhvillimit rural" në Shqipëri. Në mbledhjen e fundit qeveria shqiptare miratoi një paketë fiskale, me lehtësira të shumta për agroturizmin, duke ulur TVSH-në nga 20% në 6%. Dhe takson e tatimit nga 15% në 5%. Në këtë prizëm dhe taksa që paguhet për një ndërtime të

ri, taksa e ndikimit në infrastrukturë u bë zero. "Para dy ditësh kemi miratuar, në mbledhjen e qeverisë disa lehtësi fiskale shumë të mëdha. Agroturizmi tani trajtohet si një hotel me 5 yje, në kuptimin e lehtësirave fiskale. TVSH-ja u bë nga 20% në 6%. Ajo taksa e tatimit-fitimit u bë nga 15% që e ka një ndërmarrje nor-

male, u bë 5%. "Ministri ka premtuar, gjithashtu, dhe mbështetje për prodhimet tipike të zonave, të cilat sipas tij krijojnë të ardhura të shtuara në ekonominë familjare, duke nxitur krijimin e punishteve të vogla, që përveç të tjerave do të shërbejnë dhe si burim punësimi, kryesisht për gratë e zonave rurale.

Pronarët e tokës u gënjyen nga ndërtuesi: Policia u bë palë me të

Nga Dorjana Bezat

TIRANE

Na e kanë vjedhur pronën në bashkëpunim me seksionin e Antikrimit Ekonomik në Policinë e Tiranës". Kjo është lëngata e familjes Hametaj. Prej më shumë se 2 vitesh ata trokasën në dyert e Policisë së Tiranës dhe konkretisht në Seksionin e Krimit Ekonomik, i cili drejtohet nga Marsel Dulaj. Ata kërkonin ndihmë për të zgjidhur konfliktin me ndërtuesin që u ka marrë pronën dhe nuk u ka dhënë pjesën që u takon nga ndërtimi sipas kontratës. Familja Hametaj tregon se policia jo vetëm nuk u ka zgjidhur konfliktin, por Marsel Dulaj është bërë palë me ndërtuesin Dritan Llanaj. "Vetë në thanë 'ua çfarë genka bërë këtu'. Inxhinierit i thanë 'inxhinier je për të vajtur në burg'. Kur sot, ndërtuesi vajt në burg dhe doli. Në po e shohim qartë që këtu e ka vjedhur pronën bashkë me grupin që ka pasur", thonë ata. Specialistët e Krimit Ekonomik pas thirrjeve të pafundme të familjarëve Hametaj, kanë shkuar në objekt dhe kanë bërë një akt ekspertimi. Policët e der-

Tjetër dështim i Antikrimit Ekonomik, lirohet mashtruesi

Lëngata e familjes Hametaj: Ja si na e grabitën tokën



Shefi i Krimit Ekonomik, Marsel Dulaj

guar në terren i kanë dhënë të drejtë familjes, por pas përfundimit të këtij akt ekspertimi, titullari i seksionit, Marsel Dulaj nuk ua ka vënë në dispozicion familjes dhe as i ka takuar. "U kemi

thënë specialistëve të Krimit Ekonomik me detaje se çfarë ka ndodhur në pronën tonë. Pas pak kohësh kanë sjellë një grup inspektimi me specialistë të Krimit Ekonomik dhe u bë një inspek-



Denoncuesit e familjes Hametaj

tim që nga themeli deri në çati për ndërtim pa leje dhe për të gjithë mungesën e dokumentacionit. Dhe sot e kësaj dite që flasim ne, ky akt ekspertimi nuk na është vënë në dispozicion nga Krimi

Ekonomik", thonë anëtarët e familjes Hametaj. Denoncuesit pretendojnë se për t'u mbyllur gojën atyre dhe për t'ia kaluar topin gjykatës, shefi i Krimit Ekonomik, Marsel Dulaj,

ANKESA E FAMILJES HAMETAJ

"Diku mbas 10 ditësh, gjykata e lëshoi. Mesa dimë ne, me 'detyrim paraqitje', se provat që ka çuar policia nuk janë të mjaftueshme për të vërtetuar paligjshmërinë", thonë ata.

ka arrestuar ndërtuesin, por e ka çuar pa prova për masë arresti në gjykatë. Kjo e fundit e ka zhvlerësuar menjëherë masën e kërkuar; duke kaluar në ekstremin e "detyrimit për paraqitje" dy herë në muaj në prokurori. "Diku mbas 10 ditësh, gjykata e lëshoi. Mesa dimë ne me 'detyrim paraqitje', se provat që ka çuar policia nuk janë të mjaftueshme për të vërtetuar paligjshmërinë", thonë ata. Ky është rasti i dytë i një dështimi të bujshëm të sektorit të Krimit Ekonomik në Drejtorinë e Tiranës. Pak ditë më parë, gjykata dhe prokuroria shfrynë "tullumbacen" e kontrabandës së kafesë dhe cigareve. I trumbetuar si një operacion pjesë e "Forcës së ligjit", ai rezultoi nul, pas lirimit të të arrestuarve dhe mungesës së provave.



Implemented by **giz** Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

OPEN CALL FOR TENDER PREQUALIFICATION

1. GENERAL CONDITIONS

1.1 Requester: Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH (GIZ), Office Tirana, Rr. Skenderbej No. 21/1

1.2 Profile: The Programme "Customer Oriented Drinking Water and Sanitation Services" is implemented by the Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH (GIZ) on behalf of the German Federal Ministry of Economic Cooperation and Development (BMZ). The objective of the programme is to support the partners at central and local level in the implementation of the water sector reforms. At local level the programme supports three partner municipalities and their water utilities in the improvement of drinking water and sanitation services, especially performance orientation, accountability and in customer orientation.

1.3 Subject: The Government of Albania has started a reform on water supply and sewerage sector aiming to improve the service to the citizens, to enhance the water supply continuity and to shift the sector towards better performing.

The Government of Albania aims to expand access to and enhance the quality of water supply and sewerage services for the entire population of Albania. The ultimate aim is to provide piped water supply to all people and to provide wastewater services to protect human health and minimize negative environmental impacts. This aim will be achieved taking into account the overall policy framework:

- Government sector policies operate within a macro-economic framework that limits overall public debt and is based on sound macro-economic policies.
- The Government will give emphasis to the need to protect the poor and vulnerable inter alia by ensuring that their utility bills are within international norms for affordability.

- Albania is an EU candidate country and Government sector policies are designed with the adherence to the EU environmental acquis in mind.

Within the context of the above Background Information, the Government of Albania is seeking to retain the services of a Consultancy with proven experience in the development of water sector strategic documents, that would assist the Government to:

- Prepare twelve (12) year water supply and sewerage services sector strategy, to include an implementation monitoring mechanism.
- Recommend appropriate initiatives and procedures to support the water supply and sewerage services sector reform effort.
- Recommend and quantify the effort needed, at the national and utility level, to ensure that a capable work force is being prepared to assume operational and maintenance responsibility that will be needed to protect the assets being created under the sector capital investment program.

GIZ now invites eligible national consulting companies to indicate their interest in providing the required Services. Interested Consultants should provide information demonstrating that they have the required qualifications and relevant experience to perform the Services.

- 1.4 Eligibility:** Participation is open to all eligible national consulting companies (participating either individually or in a grouping — consortium — of tenderers) which are effectively established in Albania.

All legal entities interested in the application process should ask for [application forms](mailto:giz-albanien@giz.de) to the address: giz-albanien@giz.de

- 2.** The **due date** for submitting the application is **06.07.2018**. The documents should be submitted in a sealed envelope, marked "Application for prequalification: **National Water Supply and Sewerage Services Sector Strategy for Albania 2018-2030**" to:

**Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ)
Office Tirana, Rr. Skenderbej No. 21/1, Tirane**

After the due date for submitting the application, the process of prequalification will follow. The submitted applications will be evaluated and only prequalified candidates will be invited to answer the bid. All written communication for this procedure and the following successful ones must be in English.

Bashkëshortja e 38-vjeçarit në "News 24": S'ka pasur lidhje me masakrën e Nicës

U gjet i vdekur në burg, familjarët: Aleksandrin e vrau shteti francez

“E eliminuan për 2-3 muaj, i ngulën gjilpërë”

TIRANË

Aleksandrin e eliminuan për 2-3 muaj. I ngulën gjilpërë”. Kështu ka deklaruar vëllai i Aleksandër Hasallës, i cili dy javë më parë u gjet i vdekur në një burg të Francës. Familjarët e 38-vjeçarit, në emisionin “Me Zemër të Hapur” në “News 24” kanë dyshime të forta se nuk bëhet fjalë për vetëvrasje, ndërsa akuzuan shtetin francez se ka gisht në vdekjen e tij. Ata thanë se ai shkoi fillimisht me bashkëshorten dhe kërkuan azil për të nisur atje së bashku një jetë të re. Pas ardhjes në jetë të djalit, shteti francez kërkoi kthimin e tyre mbrapsht në atdhe dhe kështu bënë, u rikthyen të tre. Më pas, në dhjetor të vitit 2016, Aleksandri ka shkuar për t’u interesuar për dokumentet e të birit. Në 12 dhjetor të 2016-ës, para se të kthehej, policia e ka ndaluar duke e akuzuar se kishte shitur armën, e cila u përdor në masakrën e ndodhur në Nicë ku mbetën të vrarë e të plagosur me dhjetëra persona. Aleksandri ka insistuar fort se ishte i pafajshëm, ndërsa gjatë qëndrimit në burg ai dërgonte shumë letra tek familjarët. Ndër të tjera, ai theksonte gjendjen e rënduar shpirtërore dhe mallin që kishte për familjen dhe mbi të gjitha për të birin. Familjarët e tij nuk e pranojnë kurrësi versionin e vetëvrasjes, madje ata shprehën se shteti francez e ka vrarë Aleksandrin. Ata kërkojnë të vërtetën dhe deri më tani askush nuk iu thotë asgjë. “Ne ishim në shtëpitoren e Nicës kur ndodhi sulmi terrorist. Do shkonim të shihnim fishekzjarrët. Edhe ne mund të ishim vrarë. Ishim bashkë me djalin e bashkëshortin. Aleksandri punonte dhe atje u njoh edhe me çiftin që gjoja u ka shitur armën. Unë nuk e njoh çiftin shqiptar. Mbjam mend që u kthyem nga mesi i gushtit, më sollën letër që të largohesha nga Franca dy ditë pasi linda. Nëse do të qëndronim, do ishte me dënim. Aleksandri u rikthye më 19 shtator për të marrë certifikatën e djalit, ta regjistronim, që ne më pas të shkonim sërish atje. Aleksandri nuk kishte asnjë lidhje me atë që ndodhi. Kur erdhi prapë në Shqipëri, më solli certifikatën e djalit për të bërë pasaportën. Atje u ndalua dhe më thanë që u arrestua se ka shitur armë. Pas një muaji, më mori në telefon dhe më tha që as vetë nuk e kuptonte pse ishte arrestuar. Në mars të këtij viti dukej në gjendje depresioni”, tha bashkëshortja e tij, Liliana. “E eliminuan për 2-3 muaj, i ngulën gjilpërë”, po



Pjesëtarët e familjes Hasalla në "News 24"

hoi vëllai i Aleksandrit. **AVOKATJA E ALEKSANDRIT** “Ajo thoshte që kishte dyshime, jo se ishte i përfshirë. Avokatja ishte e bindur që

Aleksandri ishte i pafajshëm dhe thoshte që do bënte të pamundurën për ta shpëtuar. Na telefonuan nga Parisi dhe na thanë kur mund të sjellim trupin, kur ne e kemi

varrosur. I thashë drejtoreshës së burgut atje që pse nuk e vëzhgonit një person që ishte në depresion. Ajo më tha që vetëm një orë vëzhgohej. Nuk e di pse s’e

MASAKRA E NICËS

Në masakrën e Nicës që daton 14 korrikun e vitit 2016 humbën jetën 86 persona dhe mbetën të plagosur 450 të tjerë, pasi një terrorist u fut me kamion mes turmës së njerëzve. Aleksandër Hasalla u arrestua pasi dyshohej se i ka dhënë një armë terroristit Lahouaiej-Bouhlel, që kreu sulmin. Sipas policisë franceze, 38-vjeçari Hasalla e kishte marrë armën nga një çift shqiptar.

VIKTIMA ALEKSANDËR HASALLA

Më 12 qershor të këtij viti, mediat franceze shkruan se Aleksandër Hasalla u gjet i vdekur në qelinë e tij, në burgun e Fleury-Mérogis të Francës. Aleksandër Hasalla ishte i njohur nga drejtësia franceze për grabitje në të kaluarën, por akuzua ndaj tij lidhur me aktin terrorist nuk ishte provuar plotësisht. Dyshohet se shqiptari është vetëvarur me lidhëset e këpucëve. 38-vjeçari është i burgosur i dytë në Francë për aktet e terrorizmit, i cili kryen vetëvrasje në paraburgim.

dinin që trupin e kishim marrë dhe ne e varrosëm në Peqin. Avokatja e tij s’e dinte fare që ai kishte ndërruar jetë”, u shpreh motra e Aleksandër Hasallës.

SHKURT



Francezia e ndihmon, shqiptari e ngacmon seksualisht e tenton

ta mbyse në makinë FRANCË - Një 27-vjeçar shqiptar u dënua në mungesë për dhunë dhe kërcënim me vdekje nga e Gjykatat e Lartë e Caen (Calvados) në Francë. Historia e Gentjan Hasanit nisi më 10 prill të këtij viti, në një lagje në veri të Caenit me një grua franceze. Kur e kupton se i riu bëhet agresiv dhe i dhunshëm, zonja ndalon ta ndihmojë, por ai e ngacmon seksualisht atë. Disa incidente ndodhin pa bërë ndonjë ankesë në polici, por të martën e 10 prillit, gjërat bëhen më keq. Duke rimarrë automjetin e saj të parkuar në një parking, gruaja e gjen individin të ulur. Ai e sheh atë dhe e kap me shall duke u përpjekur ta mbyse. Vitin e kaluar i pandehuri u gjykua dhe u dënua dy herë për aktet e dhunës dhe gjithashtu për vjedhje.

Policia dokumenton bastisjet në qytetin bregdetar

Vodhën dyqane dhe lokale, arreston 2 minorenet, një tjetër nën hetim

VLORE – Policia e Vlorës ka dokumentuar disa grabitje të kryera në qytetin bregdetar, ndërsa ka arrestuar dy autorë të dyshuar dhe një tjetër është proceduar në gjendje të lirë. Në pranga kanë përfunduar I.T., 16 vjeç, banues në Vlorë si dhe R.L. 14 vjeç, banues po në këtë qytet. Gjithashtu, është proceduar në gjendje të lirë minoreni me inicialët K.B., sipas policisë, këta shtetas më datë 23.06.2018, në lagjen “28 Nëntori”, në bashkëpunim me njëri-tjetrin kanë vjedhur dyqanin e shtetasit V.M., ku kanë marrë një shumë lekësh. Po ashtu, gjatë veprimeve hetimore për zbardhjen dhe dokumentimin e të tjera vjedhjeve të kryera ka rezultuar se këta shtetas në bashkëpunim me njëri-tjetrin janë autorë edhe të vjedhjeve të mëposhtme: Më datë 08.05.2018, në lagjen “24 Maji”, kanë



vjedhur lokalin e shtetasit V.F. Më datë 18.04.2017, në lagjen “Pavarësia”, kanë vjedhur dyqanin e shtetasit E.D. Ndërsa, më datë 19.06.2018, në lagjen “Pavarësia 3”, kanë vjedhur dyqanin e shtetasit F.F. Ndërkaq, vijon puna për vënien para përgjegjësisë

së autorëve, me qëllim krijimin e një ambienti sa më të sigurt për të gjithë. Materialet hetimore iu referuan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë, ndaj shtetasve të mësipërm, për veprën penale “Vjedhja”.



Shkelën rregullat e qarkullimit, 5 shoferë përfundojnë në pranga

KORÇË - Në kuadër të planit të masave për rritjen e parametrave të sigurisë në rrugë dhe parandalimin e aksidenteve, shërbimet e Policisë Rrugore kanë ushtruar kontroll në akset rrugore në Qarkun e Korçës, ku 5 shoferë kanë rënë në pranga. Burime zyrtare nga blutë bënë me dije se në total janë vendosur 184 masa administrative për shkelje të ndryshme të rregullave të qarkullimit. Sipas policisë, pesë drejtues mjeti janë arrestuar për veprën penale “Drejtim mjeti në mënyrë të parregullt”. Ndërsa janë pezulluar 17 leje drejtimi për drejtimin e mjetit nën ndikimin e alkoolit. Janë ndëshkuar 46 të tjerë për parkim të gabuar. Janë vendosur 4 masa administrative për të meta teknike. Si dhe janë ndëshkuar me masë administrative gjithashtu 44 drejtues të tjerë, nga të cilët 37 për përdorim celulari dhe 7 për mosvendosje të rripit të sigurimit gjatë drejtimit të mjetit. Gjithashtu, janë vendosur 74 masa administrative për shkelje të tjera të ndryshme. Është bllokua 1 mjet pa dokumentacionin e nevojshëm për të qarkulluar.

Ngjarja e janarit të 2016-ës, ja si u rrëmbye dhe u vra 40-vjeçari nga Durrësi

Ekzekutimi i Gazmend Çollakut, Apeli dënon me burg përjetë Denis Shtrazën

TIRANË

Gjykata Apelit për Krimet e Rënda dje vendosi dënimin me burgim të përjetshëm ndaj Denis Shtrazës, i cili u shpall fajtor për rrëmbimin dhe vrasjen e Gazmend Çollakut. Më 19 mars të këtij viti, 32-vjeçari u dënua me burg përjetë nga Gjykata e Shkallës së Parë e Krimeve të Rënda, dënim që tashmë u konfirmua edhe nga Apeli. Më 6 janar të vitit 2016, Çollaku u rrëmbye nga katër persona në parkingun e një lokali në lagjen nr.1 të qytetit të Durrësit, ku 3 prej autorëve mbanin veshur jelekë me mbishkrimin "Policia". Autorët e krimit e kanë marrë me forcë 40-vjeçarën dhe e kanë futur në automjetin e tyre tip "Audi A6" me ngjyrë të zezë. Një ditë më vonë, Gazmend Çollaku u gjet i vrarë me plumb në kokë dhe i lidhur këmbë e duar në fshatin Murqin të Fushë-Krujës. Policia menjëherë pas ngjarjes ndaloi Denis Shtrazën dhe ish-efektivin e policisë, Ervin Dalipaj, por për mungesë provash, ata u liruan. Më pas, Shtraza u arrestua me urdhër të prokurorisë, ndërsa Dalipaj u shpall në kërkim. Ky i fundit u ekzekutua në një atentat mafioz më 7 prill të vitit 2017 në Sukth, ndaj dhe hetimet ndaj tij u pushuan. I vetmi akuzuar për rrëmbimin dhe vrasjen e Gazmend Çollakut ishte Denis Shtraza. Sipas prokurorisë, Shtraza kishte fajësuar Çollakun për plagosjen e tij në vitin 2013. Atij iu bë atentat, por mbeti i plagosur. Kështu, prokuroria thotë se Shtraza ishte betuar se do të hakmerrej për plagosjen dhe se e dinte se kush e kishte bërë atë, duke akuzuar Gazmend Çollakun. Shtraza, së bashku me ish-efektivin e policisë Ervin Dalipaj, kanë dhënë deklaratat kontradiktore në prokurori. Një nga provat më të forta të prokurorisë kanë qenë testet e ADN-së. Gjaku i Shtrazës është gjetur në mjetin e Dalipajt, me të cilin u rrëmbye dhe u vra Gazmend Çollaku. Edhe gjaku i viktimës është gjetur në bagazhin e mjetit tip "Benz" të të ndjerit Dalipaj. Me gjithë ekspertimet që i janë bërë mjetit, nuk u mundësua dot që nga GPS-i i tij të nxirreshin të dhëna të sakta për itinerarin që ai ka përshkruar ditën e rrëmbimit të Çollakut. Denis Shtraza dhe Gazmend Çollaku mësohet se kanë pasur miqësi në burg, ku kanë vuajtur dënime për vepra penale të ndryshme. Ky ka qenë edhe një argument i mbrojtjes së Shtrazës nuk ka pasur motiv



Viktima Gazmend Çollaku



I dënuari Denis Shtraza



Seanca gjyqësore

që ta ekzekutojë të ndjerin. Mirëpo, prokuroria pretendon se Shtraza ka akuzuar Çollakun për atentatin që i është bërë atij në vitin 2013.

VENDIMI I 19 MARSIT

Në arsyetimin e vendimit, gjykata theksonte faktin se gjurmët e gjakut të gjetura në makinën në pronësi

TIRANË - Gjyqtarja e Apelit në Vlorë, Brikena Ukperaj (Lubonja) ka kaluar procesin e vetingut dhe është rikonfirmuar dje në detyrë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit. "Sipas raportit të ILDKPI, Brikena Ukperaj justifikon pasurinë. Ukperaj ka apartament me vlerë 44 mijë euro në Selitë. Edhe sipas DSIIK, Brikena Ukperaj është e përshtatshme për detyrën", tha raportja e çështjes në seancën e kaluar. Gjyqtarja Ukperaj është bërë e njohur për shkak të dosjes së pronave "Karaburun", e gjykuar prej saj. Në seancën e kaluar dëgjimore për gjyqtarën

e Apelit Vlorë, Brikena Ukperaj (Lubonja) në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit ka ardhur edhe një ankimim. Behet fjalë për një familje nga Vlora, e cila pretendon pronësinë e dhjetëra hektarëve tokë në Karaburun,

të Ervin Dalipajt, ish-oficerit të ekzekutuar në një atentat mafioz në Durrës vitin e kaluar janë të viktimës Gazmend Çollaku. Për faktin se Denis Shtraza është ndaluar pak orë pas ngjarjes, duke udhëtuar me Dalipaj me makinën ku u gjetën njollat e gjakut të viktimës, gjykata ka krijuar bindjen se ai është një prej

autorëve të rrëmbimit dhe më pas vrasjes së 40-vjeçarit. Gjithashtu, sipas gjykatës rezultoi e provuar që viktimën nuk kishte njohje me Dalipaj dhe nuk ekziston asnjë mundësi që ai të ketë udhëtuar me makinën "Mercedez Benz". Mendohet se njollat e gjakut mund të kenë mbetur në automjet, nga kontakti direkt i vik-

timës me automjetin, çka do të thotë se trupi i pajetë i tij është transportuar me makinën në pronësi të Dalipajt, ose janë lënë nga ndonjë mjet i fortë me të cilin është goditur Gazmend Çollaku. Ndërkaq, në seancën e 19 marsit të këtij viti, Shtraza nëpërmjet avokati mbrojtës, Neshat Fana kërkoi pajfajësi.

IKZEKUTIMI

Më 6 janar të vitit 2016, Gazmend Çollaku u rrëmbye nga katër persona në parkingun e një lokali në lagjen nr.1 të qytetit të Durrësit, ku 3 prej autorëve mbanin te veshur jelekë me mbishkrimin "Policia". Autorët e krimit e kanë marrë me forcë 40-vjeçarën dhe e kanë futur në automjetin e tyre tip "Audi A6" me ngjyrë të zezë. Një ditë më vonë, Çollaku u gjet i vrarë me plumb në kokë dhe i lidhur këmbë e duar në fshatin Murqin të Fushë-Krujës.

ERVIN DALIPAJ

Në lidhje me vrasjen e Gazmend Çollakut u akuzua edhe ish-oficeri i policisë së Tiranës, Ervin Dalipaj. Policia menjëherë pas ngjarjes ndaloi Denis Shtrazën dhe ish-efektivin e policisë, Ervin Dalipaj, por për mungesë provash, ata u liruan. Më pas, Shtraza u arrestua me urdhër të prokurorisë, ndërsa Dalipaj u shpall në kërkim. Ky i fundit u ekzekutua në një atentat mafioz më 7 prill të vitit 2017 në Sukth, ndaj dhe hetimet ndaj tij u pushuan.



Vetingu, gjyqtarja e Apelit të Vlorës, Brikena Ukperaj rikonfirmohet në detyrë

DENONCIMET

Brikena Ukperaj nuk ishte proceduar asnjëherë nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, por raportja e trupit gjykues të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit paraqiti 12 denoncime të depozituara në këtë komisionin për gjyqtarën nga publiku. Gjyqtarja e Apelit Vlorë, Brikena Ukperaj (Lubonja) iu nënshtrua me përparësi vetingut për shkak të kandidateve për në Këshillin e Lartë Gjyqësor.



Gjyqtarja Brikena Ukperaj

por që prej vitesh nuk i është dhënë toka që ata pretendojnë se u takon. Ata akuzojnë gjyqtarën Brikena Ukperaj (Lubonja) se ka dhënë një vendim të padrejtë, duke shkelur ligjin për çështjen e tyre. Vjosa Bodo, avokate dhe

përfaqësuese e një prej familjeve hodhi akuzën ndaj gjyqtarës së Apelit të Vlorës, por ajo sot u konfirmua në detyrë nga KPK. Gjyqtarja Brikena Ukperaj (Lubonja) e ka filluar karrierën në sistemin gjyqësor në vitin

2006 me mbarimin e Shkollës së Magistraturës. Ajo ka ushtruar funksionin e gjyqtarës në Gjykatën e Tiranës, në atë të Lushnjës dhe prej nëntorit 2016 është anëtare e Gjykatës së Apelit në Vlorë.

Vendimi/Me sa pikë do të vlerësohen provimet e maturës dhe mesatarja e 3 viteve

Zbardhen kriteret e pranimit në 6 fakultete në Universitetin e Tiranës

"Si mund ta fitoni ekonomikun, juridikun e shkencat sociale"

Voltiza Duro

Maturantët janë ende në pritje të rezultateve të provimeve në lëndën e matematikës si dhe atyre me zgjedhje, për të përllogaritur kështu se në cilat degë do të kenë mundësi për të studiuar. "Gazeta Shqiptare" zbardh sot të gjitha kriteret e pranimit për vitin e ri akademik 2018-2019 në të gjashtë fakultetet e Universitetit të Tiranës si dhe në filialin e tij në Sarandë. Ky institucion i arsimit të lartë bën me dije se mesatarja e tre viteve të gjimnazit si dhe provimet e maturës shtetërore janë baza mbi të cilën do të bëhen përzgjedhjet e fituesve edhe për këtë vit. Përkatesisht theksohet se për t'u bërë pjesë e Fakultetit të Drejtësisë, maturantët duhet të dinë se 50% të pikëve do t'i ketë mesatarja e shkollës, ndërsa 50%-in tjetër do e ketë nota mesatare e lëndëve Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, Histori, Qytetari, Ekonomi e Gjuhë e Huaj me nga 10% secila prej tyre. Por, fakultetet i kanë përcaktuar vetë kriteret këtë vit, e rëndësia e mesatares apo provimeve të maturës ka vlera të ndryshme për programe të ndryshme. Kështu, Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë vlerëson me 80% mesataren e 3 viteve të shkollës së mesme dhe vetëm me 20% provimet e maturës, ndërsa për studentët që do pranohen në Fakultetin e Ekonomisë, në të gjitha programet ka 50% të pikëve mesataren dhe 50% gruplëndët përkatëse. Por prej 2 vitesh, maturantët që dëshirojnë të studiojnë në një nga institucionet e arsimit të lartë duhet të kenë një mesatare më të lartë se 6-të. Ndërkohë, UT thekson më tej se në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja 100% të pikëve i ka mesatarja e thjeshtë që del nga mbledhja aritmetike e notave të tre viteve dhe notave të marra në provimet e maturës shtetërore pjesë-



EKONOMIKU DHE SHKENCAT SOCIALE

Fakulteti i Ekonomisë

Kriteret e miratuara nga Universiteti i Tiranës, për pranimit në ciklin e parë të studimeve për vitin akademik 2018-2019, për Fakultetin e Ekonomisë janë si më poshtë:

- Nota mesatare e shkollës së mesme për të gjitha vitet, përfshirë dhe provimet e maturës shtetërore (mesatare e thjeshtë), të cilat përbëjnë 50% të vlerësimit.
- Nota mesatare e gruplëndëve (për të gjithë vitet gjatë të cilave shtrihen lëndët, përfshirë notat e maturës shtetërore), të cilat përbëjnë 50% të vlerësimit:

 - a. Matematikë 15%
 - b. Ekonomi 15%
 - c. Fizikë 10%
 - d. Gjuhë e Huaj 10%

Fakulteti i Shkencave Sociale

Kriteret e miratuara nga Universiteti i Tiranës, për pranimit në ciklin e parë të studimeve për vitin akademik 2018-2019, për Fakultetin e Shkencave Sociale janë si më poshtë:

- Nota mesatare aritmetike e tri viteve të shkollimit 50% e vlerësimit -Nota mesatare aritmetike e tri provimeve të maturës të detyrueshme (Gjuhë-Letërsi, Matematikë, Gjuhë e huaj) 40% e vlerësimit.
- Një provim me zgjedhje nga lista e provimeve me zgjedhje 10% e vlerësimit:

 - a. Qytetari
 - b. Sociologji
 - c. Filozofi
 - d. Psikologji
 - e. Histori (nga kurrikula bërthamë ose e avancuar)
 - f. Gjeografi (nga kurrikula bërthamë ose e avancuar)
 - g. Biologji (nga kurrikula bërthamë ose e avancuar)
 - h. Ekonomi (nga kurrikula bërthamë ose e avancuar)
 - i. Teknologji (nga kurrikula bërthamë ose e avancuar)

Filiali Sarandë

Kriteret e miratuara nga Universiteti i Tiranës, për pranimit në ciklin e parë të studimeve për vitin akademik 2018-2019, për Filialin Sarandë janë si më poshtë: Kriteret e pranimit për të dy programet e studimit të Filialit Sarandë do të jenë të njëjtat me kriteret që do të kenë Fakultetet bazë:

- Fakulteti i Ekonomisë programi Administrim Biznesi
- Fakulteti i Gjuhëve të Huaja programi Gjuhë Angleze

tuar me numrin në total të notave të mbledhura. Ndërsa në Fakultetin e Shkencave Sociale, 50% të pikëve të vlerësimit izë mesatarja e tre viteve të gjimnazit; 40% provimet e detyruara

të Maturës Shtetërore si dhe 10% një prej provimeve të lëndëve me zgjedhje. Ajo çka shfaqet risi në ndryshim nga fakultetet e tjera, është mënyra se si i ka ndarë

pikët e vlerësimit Fakulteti i Shkencave. Në këtë të fundit ka 50% të pikëve ku 25% është mesatarja e 3 viteve e 25% provimet e Maturës, ndërsa 50% janë gruplëndët sipas pro-

KRITERET E PRANIMIT NË 6 FAKULTETE

Fakulteti i Drejtësisë

Nota mesatare e përgjithshme (mesatare e thjeshtë), e cila përbëhet nga nota mesatare e të gjithë viteve të shkollës së mesme (përfshirë edhe notat e provimeve të maturës shtetërore), të cilat përbëjnë 50% të vlerësimit.

Nota mesatare e lëndëve të mëposhtme, të cilat përbëjnë 50% të vlerësimit:

- a. Gjuhë dhe Letërsi Shqipe 10%
- b. Histori 10%
- c. Qytetari 10%
- d. Ekonomi 10%
- e. Gjuhë e Huaj (e parë) 10%

Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë

Kriteret e miratuara nga Universiteti i Tiranës, për pranimit në ciklin e parë të studimeve për vitin akademik 2018-2019, për Fakultetin e Histori Filologjisë janë si më poshtë:

- Vlerësohet me 80% të rezultatit përfundimtar mesatarja aritmetike e tre viteve të studimit në shkollën e mesme

- Vlerësohet me 20% të rezultatit përfundimtar mesatarja aritmetike e lëndëve të Maturës Shtetërore

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

Kriteret e miratuara nga Universiteti i Tiranës, për pranimit në ciklin e parë të studimeve për vitin akademik 2018-2019, për Fakultetin e Gjuhëve të Huaja janë si më poshtë:

- Mesatare e thjeshtë e cila rezulton nga mbledhja aritmetike e notave të tre viteve dhe notave të marra në total të notave të mbledhura

FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS

Kriteret e miratuara nga Universiteti i Tiranës, për pranimit në ciklin e parë të studimeve për vitin akademik 2018-2019, për Fakultetin e Shkencave të Natyrës janë si më poshtë:

- Mesatarja e thjeshtë aritmetike e përgjithshme 50% e vlerësimit, e cila përbëhet 25% nga mesatarja aritmetike e thjeshtë e notave përfundimtare vjetore të lëndëve për të gjitha vitet e shkollimit në arsimin e mesëm të lartë dhe 25% mesatarja aritmetike e thjeshtë e notave të provimeve të maturës shtetërore.

- Nota mesatare e gruplëndëve 50% e vlerësimit (kurrikula bërthamë). Në gruplëndët përfshihen lëndët me përqindjet përkatëse :

Programi i studimit Biologji

- a. Biologji 30%
- b. Kimi 10%
- c. Fizikë 5%
- d. Matematikë 5%

Programi i studimit Bioteknologji

- a. Biologji 20%
- b. Kimi 10%
- c. Fizikë 10%
- d. Matematikë 10%

Programet e studimit Kimi; Kimi Industriale dhe Mjedisore; Kimi dhe Teknologji Ushqimor

- a. Kimi 20%
- b. Biologji 10%
- c. Fizikë 10%
- d. Matematikë 10%

Programi i studimit Matematikë

- a. Nota mesatare e tri viteve të lëndës Matematikë 50%

Programi i studimit Fizikë

- a. Fizikë 20%
- b. Matematikë 20%
- c. Kimi 5%
- d. Biologji 5%

Programi i studimit Informatikë; Teknologji Informatik dhe Komunikimi

- a. Matematikë 25%
- b. TIK 10%
- c. Fizikë 10%
- d. Biologji 5%

Programi i studimit Inxhinieri Matematike dhe Informatike

- a. Matematikë 30%
- b. Nota mesatare e matematikës në maturën shtetërore 20%

ISSH: Kriteret, sa duhet të jetë moshë për burrat dhe gratë, vitet e punës

Vendimi: Rritja e pensioneve, sa do të përfitojnë ushtarakët

Të gjitha kategoritë që do të marrin më shumë para

Voltiza Duro

Prej 1 korrikut të këtij viti, ushtarakët në lirim do të përfitojnë rritje pensioni. Sipas vendimit më të fundit të qeverisë, do të bëhet indeksimi në masën 2.8% i pensioneve të caktuara dhe të rillogaritura me ligjin "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit dhe punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me përjashtim të pensioneve të caktuara me nenin 21, të këtij ligji. "Këshilli i Ministrave vendosi indeksimin, në masën 2.8 për qind, të: pensioneve të caktuara me dekretrin nr.758, datë 1.2.1994, të Presidentit të Republikës, "Për një mbrojtje të veçantë të ushtarakut"; trajtimeve të veçanta financiare, të caktuara sipas ligjit nr.9361, datë 24.3.2005, "Për një trajtim të veçantë financiar të efektivave, oficerë dhe nënofficerë, lundruet të nëndësëve dhe palombarëve të forcave detare në pension"-, theksohet në vendim. Gjithashtu, në këtë të fundit bëhet me dije se nga kjo rritje do të preken edhe trajtimet e veçanta financiare të caktuara sipas ligjit nr.9179, datë 29.1.2004, "Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake".

Ndërkohë indeksimin, e përfitojnë edhe pensionet që do të caktohen nga data 1.7.2018 e në vazhdim, me kusht që data e fillimit të pensionit të jetë deri më 30.6.2018, përfshirë edhe këtë datë. "Shuma bazë e pensionit, e përcaktuar sipas pikës 2, të nenit 32, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, duke filluar nga data 1.7.2018 e në vazhdim të jetë 7 262 lekë. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi përlogariten në shumën 1 545 000 000 lekë dhe përballohen nga fondit për politikë e indeksimit të pensioneve, i parashikuar në buxhetin e ISSH-së të vitit 2018", nënvizohet më tej në vendim.

KRITERET

Sipas ligjit, ka disa lloje përfitimesh që administrohen nga ISSH-ja, e respektivisht bëhet fjalë për: pensionin e parakohshëm për vjetërsi shërbimi; pensionin suplementar të pleqërisë; pensionin suplementar të invaliditetit; si dhe për atë



DOKUMENTACIONI

Për pensionin të parakohshëm:

- Fotokopje e kartës së identitetit.
- Deklaratë për punësimin (e përvitshme).
- Vërtetim nga zyra e Tatim-Taksave.
- Vërtetim nga zyrat e punës si punëkërkuess.
- Vërtetim nga zyra e regjistrimit të pasurive.

Për pensionin suplementar të pleqërisë:

- Fotokopje e kartës së identitetit.
- Për pensionin suplementar të invaliditetit:
- Fotokopje e kartës së identitetit.

Për pensionin suplementar familjar:

- Certifikatë familjare.
 - Certifikatë e vdekjes së personit.
 - Fotokopje e kartës së identitetit së përfutuesit.
 - Vërtetim për vazhdimin e shkollës për jetimët që kanë mbushur moshën ligjore për t'u punësuar.
 - Deklaratë për punësimin apo aktivitetin ekonomik.
- Për pensionin suplementar familjar, kur ushtarakët humbasin jetën në detyrë apo për shkak të saj:**
- Certifikatë familjare.
 - Certifikatë e vdekjes së personit.
 - Fotokopje e kartës së identitetit së përfutuesit.
 - Vërtetim i vazhdimit të shkollës për jetimët.
 - Deklaratë për punësimin apo aktivitetin ekonomik.

2.8%

RRITJE E PENSIONIT

Sipas vendimit më të fundit të qeverisë, do të bëhet indeksimi në masën 2.8% i pensioneve të caktuara dhe të rillogaritura me ligjin "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve.

familjar. Kështu për të përfituar pensionin e parakohshëm për vjetërsi shërbimi, burrat duhet të kenë mbushur moshën 47 vjeç e të kenë jo më pak se 15 vite pune, ndërsa gratë duhet të jenë mbi 42 vjeç e të kenë jo më pak se 12 vite shërbimi. Ndërkohë mund të përfitojnë pension suplementar pleqërie të gjitha kategoritë e

sipërpërmendura, dhe pension suplementar invaliditeti po këto kategori që janë deklaruar invalidë dhe përfitojnë pension invaliditeti të plotë apo të pjesshëm, sipas Ligjit nr. 4171, "Për sigurimet shoqërore të RPSH" dhe Ligjit nr. 7703, "Për sigurimet shoqërore në RSH". Instituti i Sigurimeve Shoqërore bën me dije se kur

personat e familjes në ngarkim të personave të sipërpërmendur dhe familjet e ushtarakëve që humbasin jetën në krye të detyrës e përfitojnë pension familjar, sipas Ligjit kanë gjithashtu të drejtën e marrjes së pensionit suplementar familjar.

DOKUMENTACIONI

Personat e interesuar duhet të paraqiten në Agjenc-

KATEGORITË PËRFITUESE:

- Ushtarakët e Forcave të Armatosura në RSH;
- Punonjësit e Policisë së Shtetit;
- Punonjësit e Gardës së RSH;
- Punonjësit e Shërbimit Informativ të Shtetit;
- Punonjësit e Policisë së Burgjeve;
- Punonjësit e Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit;
- Punonjësit e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm;
- Punonjësit e Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

Kriteret

a) **Pensioni i parakohshëm për vjetërsi shërbimi.**
Kushtet për përfitim: - Për burra: moshë 47 vjeç dhe jo më pak se 15 vite shërbimi; - Për gra: moshë 42 vjeç dhe jo më pak se 12 vite shërbimi.

b) **Pension suplementar i pleqërisë.**
Kushtet për përfitim: - Personat e përmendur në pikën 2 të këtij kreu, që përfitojnë pension pleqërie sipas Ligjit nr. 4171, datë 13.09.1966 "Për sigurimet shoqërore në RPSH" dhe Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në RSH", i ndryshuar.

c) **Pension suplementar i invaliditetit.**
Kushtet për përfitim: - Personat e përmendur në pikën 2 të këtij kreu, kur janë deklaruar invalidë dhe përfitojnë pension invaliditeti të plotë apo të pjesshëm, sipas Ligjit nr. 4171, datë 13.09.1966 "Për sigurimet shoqërore në RPSH" dhe Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në RSH", i ndryshuar.

d) **Pensioni suplementar familjar.**
Kushtet për përfitim: - Kur personat e familjes në ngarkim të personave të përmendur në pikën 2 të këtij kreu, përfitojnë pension familjar, sipas Ligjit nr. 4171, datë 13.09.1966 "Për sigurimet shoqërore në RPSH" dhe Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në RSH", i ndryshuar.

e) **Pensioni suplementar familjar,** për personat që humbasin jetën në detyrë apo për shkak të saj Kushtet për përfitim: - Personat e përmendur në pikën 2 të këtij kreu, që humbasin jetën në detyrë apo për shkak të saj.

inë Lokale të Sigurimeve Shoqërore ku kanë vendbanimin dhe të pajisen me dy formate kërkesë. "Një format kërkesë i plotësuar paraqitet në strukturat nga ku kenë ndërprerë karrierën ushtarake dhe kenë dalë në rezervë/lirim apo pension pleqërie. Mbi bazë të kësaj kërkesë, këto struktura dërgojnë në rrugë postare modelarin nr. 3 "Vërtetim për vjetërsinë në shërbim dhe pagën mesatare neto referuese" në strukturën rajonale të sigurimeve shoqërore, ku kenë vendbanimin", - citohet në manualin e ISSH-së. Ndërkaq, formatit tjetër të kërkesës, plotësuar në të gjitha rubrikat, i bashkëlidhet dokumentacioni përkatës dhe dorëzohet pranë ALSSH, ku individit ka vendbanimin. Por, aplikantët duhet të bëjnë kujdes, pasi data e regjistrimit të kërkesës është tepër e rëndësishme.

Personi që kërkon përfitimet jo më vonë se 1 vit nga data kur i lind kjo e drejtë, përfitimi i paguhet nga data e lindjes së të drejtës. Në raste të tjera, përfitimi paguhet nga data e paraqitjes së kërkesës për përfitim. Përveç kërkesës, të interesuarit duhet të bashkëngjiten edhe dokumentacionin përkatës. Kështu, për pension të parakohshëm, aplikanti duhet të dorëzojë edhe një fotokopje të kartës së identitetit, deklaratë për punësimin (e përvitshme), vërtetim nga Zyra e Tatim-Taksave, vërtetim nga zyrat e punës si punëkërkuess, vërtetim nga zyra e regjistrimit të pasurive. Ndërsa për pensionin suplementar të pleqërisë e atë të invaliditetit, kandidati duhet të dorëzojë edhe një fotokopje të kartës së identitetit.

Zaev: Qytetarët do të shprehen në referendum për marrëveshjen historike

Emri i Maqedonisë, Ivanov ende s'ka ratifikuar ligjin

MB, letër NATO-s: Të marrim ftesë për anëtarësim

Pas miratimit në Kuvend të marrëveshjes për emrin e Maqedonisë, presidenti i kësaj të fundit, Gjorge Ivanov, ende se ka firmosur ligjin për ratifikim e saj. Nëse Ivanov deri nga mesi i javës së ardhshme kur dhe pritet të skadojë afati mbetet në qëndrimin fillestar se nuk do ta firmos, ligji do të kthehet për rivotim në Kuvend. Me vonë, në bazë të Kushtetutës, Presidenti është i detyruar ta hedh firmën, edhe pse Kushtetuta nuk parashikon asnjë alternativë për dalje nga situata nëse edhe pas rivotimit të ligjit në Kuvend, Ivanov vendos ta mbajë ligjin në arkivë. Gjithsesi kryeministri, Zoran Zaev tha se asgjë nuk varet as nga Ivanovi e as nga politikanët tjerë, por se për marrëveshjen fjalën e fundit e kanë qytetarët. Në një intervistë për të përditshmen serbe "Politika", Zaev shprehu optimizëm se referendumi do të jetë i suksesshëm. "Qytetarët do të shprehen në referendum për marrëveshjen historike me të cilën shteti ec përpara. Jam optimist dhe besoj se referendumi do të ketë sukses, ndërsa kjo do të thotë sukses për secilin qytetar të Maqedonisë. Fjalën e qytetarëve do të duhet ta respektojnë të gjithë, edhe Presidenti Ivanov edhe opozita, edhe ne si qeveri - deklaroi Zoran Zaev. Ndërkohë kryediplomati grek, Nikos Kocias gjatë ditës do t'i firmosë letrat, të cilat nesër do të arrijnë në NATO dhe BE. Përmes kësaj korrespondence, Greqia do të shprehë mbështetjen e saj që vendi të fillojë negociatat për anëtarësim në këto dy organizata ndërk-



Gjorge Ivanov



Zoran Zaev

ZORAN ZAEV

"Qytetarët do të shprehen në referendum për marrëveshjen historike me të cilën shteti ecën përpara. Jam optimist dhe besoj se referendumi do të ketë sukses, ndërsa kjo do të thotë sukses për secilin qytetar të Maqedonisë. Fjalën e qytetarëve do të duhet ta respektojnë të gjithë, edhe presidenti Ivanov edhe opozita, edhe ne si qeveri," - deklaroi Zoran Zaev

mbëtare. Një mbështetje të tillë, ministrja e Mbrojtjes, Radmilla Shekerinska tashmë e ka kërkuar nga të gjitha shtetet anëtare të NATO-s. Me letrën drejtuar homologëve të saj, She-

erinska thekson se me pranimin e vendit në NATO do të konsolidohet demokracia dhe do të forcohet stabiliteti dhe siguria e gjithë rajonit. Letra e ministres Shekerinska drejtua-

ar shteteve anëtare të NATO-s. "Ju shkruaj për arritjen e marrëveshjes historike rreth çështjes së emrit me Greqinë. Kjo pengesë për integrimin tonë euro-atlantik është mënjanuar. Kërkoj mbështetjen tuaj që Maqedonia të marrë ftesë për anëtarësim të plotë në NATO në samitin e ardhshëm." Për Moskën vendimi për anëtarësim në NATO do të ishte gabim me pasojë. "Kuptohet, nuk do të hedhim bomba nukleare. Secili vend ka të drejtë të sjellë vendime dhe të bëjë gabime. Por disa gabime,

RADMILLA SHEKERINSKA

"Ju shkruaj për arritjen e marrëveshjes historike rreth çështjes së emrit me Greqinë. Kjo pengesë për integrimin tonë euro-atlantik është mënjanuar. Kërkoj mbështetjen tuaj që Maqedonia të marrë ftesë për anëtarësim të plotë në NATO në samitin e ardhshëm",- shkruan në letër ministrja Shekerinska.

kanë pasojë"- tha Vladimир Çizhov, përfaqësuesi i përhershëm i Rusisë në BE. Samiti të NATO-s në korrik, i paraprini ai i Bashkimit Evropian në fund të këtij muaji. Megjithatë nëse do të marrim datë për fillim të negociatave për anëtarësim në BE varet nga Franca, e cila në mënyrë më të ashpër po kundërshton një gjë të tillë. Gjermania dhe së fundmi edhe SHBA-të përmes sekretarit, Majk Pompeo hapur i kërkuan Parisit që të heqë dorë nga kjo rezistencë, shkruan Alsat M.

SHKURT

Grabitje në Angli, 1 i vdekur dhe 2 në gjendje kritike

Një person humbi jetën ndërsa dy të tjerë ndodhen në gjendje të rëndë për jetën, gjatë një grabitjeje të ndodhur në Bristol të Anglisë. Sulmi ndodhi në rrugën Prewett, Redcliffe, pak pas orës 01:00 të së hënës. Për ngjarjen e rëndë autoritetet policore arrestuan 2 persona nga Londra të moshës 25 dhe 37 vjeç. Ata u kapën gjatë kohës që po tentonin të largoheshin nga vendngjarja. Policia tha se u njoftua për një grabitje të dhunshme dhe në kohën kur shkoj gjeti disa persona, të cilët ishin sulmuar nga autorët. Viktima mësohet se ndërroi jetë në vendngjarje, për shkak të plagëve të marra, ndërsa dy të plagosurit u dërguan me urgjencë në spital.

Banorët përplasen për tokën, 86 të vdekur në Nigeri

Të njëjtë 86 persona na gjetën vdekjen në Nigerinë Qendrore, pas një përplasjeje të dhunshme mes fermerëve dhe barinjve në shtetin e Plateau. BBC shkruan se sipas disa raportimeve, përplasia nisi të enjten, kur fermerët me etni Berome sulmuar barinjtë Fulani, duke vrarë 5 prej tyre. Një sulm hakmarrës të dielën çoi në më shumë viktima. Kjo zonë ka një histori 10-vjeçare dhune mes dy grupeve etnike që kërkojnë të zotërojnë tokën. Aktualisht, autoritetet nigeriane kanë vendosur shtetëritë në tre pjesë të shtetit të Plateau, që pritet të zgjasë të paktën 12 orë. Zyrtari i policisë, Undie Adie tha se nga kërkimet nëpër fshatra, pas përplashes së dhunshme u zbulua se numri i viktimave ishte 86, ndërsa 6 të tjerë kishin mbetur të plagosur. 50 shtëpi raportohen të djegura, ashtu sikurse edhe 15 motoçikleta dhe 2 makina. Konflikti në këtë zonë vijon prej shumë kohësh, por kurrë më parë nuk kishte arritur në një shkallë të tillë brutaliteti.

Kotzias: Zgjedhja t'i nënshkruaj vetë në Bruksel letrat

Greqia, letër Këshillit Evropian dhe NATO-s: S'pengojmë integrimin e Maqedonisë

Ditën e djeshme, Greqia i ka dërguar letër Këshillit Evropian dhe NATO-s për t'i njoftuar rreth marrëveshjes me Maqedoninë për zgjidhjen e emrit të arritur para një javë në Prespë. Në letrën e dërguar nga Greqia drejtë KE-së dhe NATO-s theksohet se ajo nuk do të kundërshtojë rrugën për integrimin evropian dhe euro-atlantik të Maqedonisë, që është edhe përbushje e pjesës së saj të obligimeve nga marrëveshja për zgjidhje të kon-

NIKOS KOTZIAS

"Në zyrën time diplomatike i kemi përgatitur letrat. Zgjedhja t'i nënshkruaj vetë në Bruksel të dielën që të hënën në mëngjes të dorëzohen deri të Bashkimit Evropian dhe NATO. Ato janë letra të cilat duhet thënë se kam qenë i njoftuar nga pala tjetër për ratifikimin e marrëveshjes në Kuvend dhe se në bazë të obligimeve dhe parakushteve, të cilat i kam vendosur, mund të vazhdojnë përpara", - tha Kotzias.

testit për emrin. Në këshillin e BE-së për punë të përgjithshme në Luksemburg do të shqyrtohet fillimi i negociatave për anëtarësimin për Maqedoninë dhe Shqipërinë

në BE. Këtë e paralajmëroi edhe shefi i diplomacisë greke, Nikos Kotzias, ku të premtën në një konferencë në ishullin Rodos, para gazetarëve paralajmëroi se



Nikos Kotzias

letra do të dërgohet mëngjesin e sotëm drejtë selisë së BE-së dhe në NATO-s. "Në zyrën time diplomatike i kemi përgatitur letrat. Zgjedhja t'i nënshkruaj vetë në Bruksel të dielën që të hënën në mëngjes të dorëzohen deri të Bashkimit Evropian dhe

NATO. Ato janë letra, të cilat duhet thënë se kam qenë i njoftuar nga pala tjetër për ratifikimin e marrëveshjes në Kuvend dhe se në bazë të obligimeve dhe parakushteve, të cilat i kam vendosur, mund të vazhdojnë përpara"-tha Kotzias.

Takimi i liderëve europianë në Bruksel, ja çkërkoj se cilin

Përfundon minisamiti i BE-së, pa rezultat për zgjidhjen e çështjes për emigrantët

Propozime të shumta, por asnjë zgjidhje e qartë. Ky ishte rezultati i minisamitit të 16 liderëve europianë për çështjen e emigrantëve të jashtëligjshëm, zhvilluar të dielën në Bruksel. Në tryezën e diskutimeve u hodh plani për ngritjen e pikave të pritjes dhe

përzgjedhjes së emigrantëve jashtë kufijve të Bashkimit Europian. Austria propozon Ballkanin si vendqëndrim, ndërsa Italia Afrikën Veriore. Kryeministri italian kërkon forcimin e kufijve europianë dhe propozon që procedurat e azilit të mos ndiqen në vendin e parë ku refugjatët shkelin, por ata ta përzgjedhin vetë shtetin ku duan të qëndrojnë. Në këtë pikë mori edhe mbështetjen e Greqisë e Spanjës, vende të kon-

sideruara si porta hyrëse e emigrantëve në Bashkimin Europian dhe që mbajnë barrën më të madhe. Kryeministri grek, Cipras kërkoj të ketë ndarje të përgjegjësi, por për kancelaren gjermane Angela Merkel, përzgjedhja nuk mund të lihet në dorë të refugjatëve. Së bashku me presidentin francez, ajo është për variantin e shpërndarjes me kuota të refugjatëve dhe dëbimin e menjëhershëm të emigrantëve ekonomikë. Për



uljen e flukseve ilegale, shefja e qeverisë së Berlinit kërkon më tepër bashkëpunim me vendet e origjinës si Libia. I vetmi vendim i marrë ishte ai për çlirimin e fondeve për vendet që strehojnë refug-

jatë, 3 miliardë Euro për Turqinë dhe 500 milionë për Libinë. Kreu i Këshillit Europian, Donald Tusk propozoi që të hartohen plane konkrete zgjidhjeje për t'u diskutuar në samitin e të enjtes.

Aktivistët: Mediat s'kanë qenë të lira për të raportuar të gjitha palët

Rishpallet president, Erdogan sërish në krye të Turqisë

I pari kryetar vendi edhe me kompetencat e kryeministrit



RECEP TAYIP ERDOGAN

"Kombi më ka dhënë besimin dhe përgjegjësinë e presidencës dhe detyrës ekzekutive. Mesazhi është i qartë. Me dalje gati 90 për qind, Turqia i ka treguar gjithë të botës mësim për demokracinë. Dëshiroj të falënderoj të gjithë qytetarët, pavarësisht se nga cila parti janë, që kanë dalë në zgjedhje për të shfrytëzuar të drejtën e tyre demokratike", tha Erdogan gjatë një fjalimi televiziv nga Stambolli.

se nga cila parti janë, që kanë dalë në zgjedhje për të shfrytëzuar të drejtën e tyre demokratike", tha 64-vjeçari. Presidenti rus, Vladimir Putin ka përzgjedhur Erdoganin për rizgjedhjen e tij, duke thënë se rezultatet kanë treguar "autoritet të madh politik dhe mbështetje masive". Turqia mbetet në gjendje të jashtëzakonshme, e cila është vënë që pas përkjesjes për grusht shteti në

korrik të vitit 2016. Zgjedhjet u mbajtën nën masa të repta sigurie. Vetëm në Stamboll më 38 mijë policë kanë qenë në detyrë. Shqetësime për kërcënimin e mundshëm të votuesve ka pasur sidomos në zonat juglindore të Turqisë, ku vota kurde ka qenë e rëndësishme për rezultatit. Aktivistët e të drejtave të njeriut po ashtu kanë thënë se mediat nuk kanë qenë të lira për

të raportuar për të gjitha palët. Erdogan ka dominuar politikën turke për më shumë se 15 vjet, fillimisht si kryeministër dhe nga viti 2014 si president. Sipas grupeve monitoruese, nën sundimin e Erdoganit, Turqia është bërë vendi që ka burgosur më së shumtë gazetarë në botë. Ndërkohë që analistët nga ana tjetër druhet se Turqia do të zhytet më thellë në kthetrajt dhe një regjimi autoritar pas fitores bindëse të Erdoganit. Pushteti që po merr nga shndërrimi i vendit në Republikë Presidenciale e bën Erdoganin njeriun më të fuqishëm në historinë moderne të Turqisë që pas Atatürkut. Ajo që shqetëson politologët është fakti se ai ia ka dalë të dobësojë opozitën, e cila nuk ka më forcë për ta mposhtur. Erdogan triumfoi bindshëm në zgjedhjet e së dielës. Ai u rizgjedh president për një mandat të dytë, me një mbështetje popullore prej 52.5%. Me ndryshimet kushtetuese të vitit të kaluar, Erdogan shndërron në të parin president turk që merr edhe kompetencat e kryeministrit. Edhe në parlament, Partia e tij për Drejtësi dhe Zhvillim siguroi shumicën për të kaluar çdo reformë, që zgjeron kompetencat presidenciale falë koalicionit me nacionalistët e renditit të tretët. Rivali i tij kryesor, Muharrem Ince i konsideroj zgjedhjet jo të ndershme. Ai hedh dyshime për manipulime, pasi referuar sondazheve, shprehte bindjen se do të përballje me Er-

REZULTATI I ZGJEDHJEVE

Sipas komiteti Suprem të Zgjedhjeve (YSK), 99.1 për qind të votave janë numëruar. Sipas tij, votat e mbetura nuk do të ndikojnë në rizgjedhjen e Erdoganit. YSK pritet të publikojë rezultatet përfundimtare në 10 apo 11 ditë në vijim. Në po të njëjtën kohë, agjencia shtetërore e lajmeve "Anadolu", raportoi se me gati të gjitha votat e numëruara, Erdogani fitoi 53% të tyre, ndërsa rivali i tij më i afërt, Muharrem Ince, 31%. Sipas burimit të njëjtë, AKP-ja kryeson me 43% të votave, ndërsa opozita Popullore Republikane, ka 23%.

doanin në raundin e balotazhit. Të parët që uruan Erdoganin për rizgjedhjen ishin liderë të shteteve të akuzuar nga perëndimi për autoritarizëm, mes të cilëve presidenti rus Vladimir Putin, ai hungarez Viktor Orban e Apatollahu Kamenei e Iranit. Ndërsa shefi i NATO-s Jens Stoltenberg e përgëzoi atë për fitoren dhe bëri thirrje që Turqia të vijojë bazohet tek vlerat demokratike si gjithë partnerët e aleancës.

SHKURT

Takimi Trump-Putin, Bolton shkon në Evropë

Këshilltari për Siguri Kombëtare i Shteteve të Bashkuara, John Bolton, u nis të hënën në një turne në Evropë. Ai pritet të takojë aleatët amerikanë në Londër dhe Romë, përpara se të udhëtojë drejt Rusisë, më 27 qershor. Një zëdhënës i Kremlinit ka thënë ditë më parë se Bolton do të diskutojë me zyrtarët rusë mundësitë për takimin e presidentit amerikan, Donald Trump dhe me homologun rus, Vladimir Putin. Ministria e Jashtme e Rusisë tha se Bolton do të takojë ministrin Sergei Lavrov gjatë vizitës në Moskë. Sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo, tha në fundjavë se Trump me gjasë do të takojë Putinin "në një të ardhme jo shumë të largët". Lokacioni i takimit të tillë nuk është zgjedhur, edhe pse zyrtarët kanë thënë se ai mund të zhvillohet në Vjenë.

Habit presidenti i Filipineve, quan Zotin 'budalla'

Presidenti i Filipineve, Rodrigo Duterte, i njohur për deklaratat e tij kontraverse, kësaj herë ka shkruar shumë larg, duke e konsideruar Zotin "budalla". Presidenti 72-vjeçar u mor me konceptin e mëkatit origjinal në Bibël. "Adami e hëngri atë... atëherë doli keq. Kush është ky Perëndi budalla? Ky djalë i një biri k... është budalla nëse është kështu. Ju keni krijuar diçka të përsosur dhe më pas mendoni për një ngjarje që do të tundojë dhe shkatërroj cilësinë e punës suaj", tha ai. Presidenti tha se foshnjat nuk mund të jenë përgjegjëse për mëkatin origjinal. "Kjo ishte vepra e nënës dhe babait tënd, nuk ishit ende të lindur, por tani keni mëkatin origjinal. Çfarë lloj feje është kjo? Unë nuk mund ta pranoj atë", tha Duterte, i cili shtoi se ende beson në ekzistencën e "një mendjeje universale".

Përfituesit duhet të shkojnë në ZRPP Tiranë për të bërë aplikimin

Ornela Manjani

Hipoteka publikon listën me 305 persona na që kanë përfituruar lejen e legalizimit dhe që duhet t'i drejtohen Zyrrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme në Tiranë për të aplikuar për certifikatat pronësie. Përfituesit janë në Tiranë. Procedurat për marrjen e tapisë janë ndjekur nga ALUIZNI, i cili dorëzon dosjen e plotë në Hipotekë, por përfituesit duhet të shkojnë në Zyrrën e Regjistrimit të Pasurive të aplikojnë për tapinë. Pas ndryshimeve të fundit ligjore qytetari do të marrë një kopje për të vërtetuar mbarimin e pro-

Hipoteka: 305 persona na kanë gati tapitë e shpërive

Certifikatat e pronësisë për të gjithë njësitë bashkiake

cesin të legalizimit, por gjithë procedura vijuese për regjistrimin në Zyrrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme do të bëhet nga Agjencia. Ndërkohë që sipër-

faja e parcelës, për të cilën miratohet kallimi i së drejtës së pronësisë, nuk mund të jetë më e madhe se trefishi i sipërfaqes së bazës së ndërtimit dhe për ndërtimet pa leje me

funkcion banimi jo më shumë se 500 m². Sipërfaqet mbi masat e përcaktuara në këtë pikë, të cilat, për shkak të përmasave ose konfiguracionit nuk mund të shfrytëzohen

më vete për ndërtim, i shiten poseduesit të ndërtimit pa leje sipas vlerës së pronës, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, vetëm nëse ka shprehur më

parë vullnetin, nëpërmjet një kërkesë me shkrim. Ndërsa në rastin kur ndërtimi pa leje disponohet nga më shumë se një person fizik ose juridik, regjistrimi i pjesëve takuese mbi pasuritë (parcelë dhe objekt) kryhet: në pjesë të pandara, ideale, sipas numrit të subjekteve; në pjesë takuese të ndara, sipas marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet subjekteve lirish dhe të depozituar brenda afatit të vetëdeklarimit. Subjektet mund të përcaktohen përveç pjesës takuese edhe pjesët fizike respektive nëse ndërmjet tyre përputhet vullneti.

305 PERSONAT QË KANË GATI TAPITË

Table with 4 columns: NR, EMER, ATESTA, MBIEMER, DREJTORIA, NJESIA. Lists 305 individuals and their corresponding administrative units.

Bjarke Ingels u vlerësua nga "Time" dhe "Wall Street Journal"

21 çmime ndërkombëtare, kush është arkitekti i Teatrit të ri Kombëtar

Arkitekti i njohur, studio me 400 punonjës. Projektoi "Two World Trade Center" në SHBA

Arkitekti danez, Bjarke Ingels, është projektuesi i Teatrit Kombëtar në kryeqytet. Themelues dhe partner i "Bjarke Ingels Group" (BIG), 43-vjeçari vlerësohet për konceptet sociale në arkitekturën e tij. Studio e Bjarke Ingels numëron një staf prej 400 personash.

Ai ka ndërtuar një sërë objektesh, që i kanë dhënë emër në botë. Bjarke Ingels ka projektuar "Two World Trade Center" në Nju Jork, ndërsa në vitin 2017 ai dhe kompania e tij ishte në qendër të një dokumentari të quajtur "Big Time". Midis punëve të tij të shumta është dhe kompleksi i ri i zyrave të "Google", apo "Eurocity" në Francë.

Në vitin 2011, gazeta e madhe ekonomike amerikane "Wall Street Journal" e vlerësoi Ingelsin si "Inovatori i Vitit" për arkitekturën, ndërkohë që "Time Magazine" në vitin 2016 e përfshiu atë në "100 njerëzit më me influencë". Bjarke Ingels ka marrë 21 çmime ndërkombëtare të ndryshme.

PREZANTIMI I TEATRIT TË RI KOMBETAR

Pak ditë më parë, arkitekti danez Bjarke Ingels ka prezantuar në sallën COD projektin e Teatrit të ri Kombëtar të realizuar në një prej studiove më të mëdha ndërkombëtare të arkitekturës në botë, "Bjarke Ingels Group". Bjarke ka shpjeguar se i ofron kryeqytetit shqiptar një godinë të arkitekturës me dizajn modern dhe që krijon një hapësirë frymëzuese për banorët.

Nga planimetria e projektit, teatri i ri nuk do të ketë kullë, por zona përreth do të pësojë ndryshime dhe është konceptuar si një bllok ndërtimesh me apartamente dhe biznese. Duke vërejtur projektin, të bie në sy se edhe Teatri Eksperimental "Kujtim Spahivogli" do të prishet, ku hapësira e tij do të përfshihet nga godina e re.

1. Teatri Kombëtar do të jetë pranë me parkun "Rinia" dhe Bulevardin dhe sheshin "Skënderbej" të gjallëruar. Pra, kemi një kombinim të një qyteti të dendur, ku njerëzit mund të ecin dhe kemi një mori hapësirash publike nga ana tjetër. Sigurisht sheshi "Skënderbej" është një ringjallje e mrekullueshme, që iu ka dhënë një dinjitet të ri të gjitha ndërtesave rreth tij.

2. Pikërisht aty në një anë, në mes të sheshit "Skënderbej" mes bulevardit dhe sheshit kemi një hapësirë këmbësorësh midis sheshit dhe teatrit, dhe gjatë punës kemi për qëllim ta zgjerojmë sa më shumë vizionin e lidhjes mes qendrës dhe qytetit, të bëjmë më shumë lidhje me ambientet e gjelbra. Rrethohemi me ndërtesa publike me ngjyra të verdha. E quajmë logjike ta mbajmë teatrin këtu.

3. Për të krijuar lidhjen mes këmbësorëve përmes

bllokut për ta bërë përbërjen në një marrëdhënie sa më të gjallë që të jetë e mundur, jemi këtu ku janë shëtitoret, që ta lidhim teatrin me qendrën e qytetit. Pra, synojmë të lidhim ndërtesat e ndryshme duke nisur nga bulevardi deri në qendrat tregtare.

4. Teatri ka ekzistuar aty, i ndërtuar nga italianët dhe që ka shërbyer për shumë vjet. Pra, janë ndërtesa që nuk janë të afta për të akomoduar një teatër kombëtar. Pashë pamjet që zoti Rama ma tregoi teatrin nga brenda.

5. Të dyja pjesët duket se ndërveprojnë mes tyre nëpërmjet sallës së madhe të teatrit si dhe dy sallave "Black Box" që u janë kush-tuar shfaqjeve. Duke krijuar një triptikë të vendtakimeve, bëhet e mundur që mekanizmi përpara godinës të jetë shumë i thjeshtuar. Godina është parashikuar si një makinë efikase, por poetike e teatrit. Të gjitha programet janë vendosur në mënyrë optimale në aspektin e funksionalitetit, ndërsa krijojnë një përvojë spektakolare për spektatorët në teatër.

6. Këtu shihni skenat eksperimentale, që të mund t'i shihni. Kjo është pamja jonë. Nga njëra anë jemi me fytyrë nga reja, nga parku. Do të jetë

lidhja urbane me nivele të ulëta dhe do të mbetem me vëllime të ulëta me ndërtesa ekzistuese rreth teatrit. Ka disa ide, nga njëra anë synojmë të krijojmë një lloj hapësirë për shfaqjet që janë pjesë e skenës, që të ketë një lloj larmie, ndërkohë përfshihet auditoriumi, kafeja, vendet e ndenjes, që të dy teatrot "Black Box" të jenë pjesë e anëve të ndërtesës, që kur ka prova shfaqjeje, mund të dallohet kur njerëzit shohin nga jashtë si aktorin, edhe regjisorin.

7. Brenda këtij konfigurimi shumë efektiv, shumë të thjeshtë që duam të krijojmë një placë që sheh nga shëtitortja, që duam ta ngremë në pjesën e mesme për të krijuar një lloj harku. Kjo kërkon një auditor informel në pjesën e çatisë, kjo pak a shumë është diagrama e ndërtesës, siç e përfytyrojmë. Përfytyroni këtë hapësirë të mbuluar, siç duhet të jetë, që shfaqjet të zhvillohen në një mjedis të hapur.

8. Pjesa me të verdhë është formati klasik i skenës së teat-

rit dhe çatia ka pesë hapësira për zhvillimin shfaqjeve, që mund të programohen në njëjtën kohë, që teatri të bëhet pikë lidhjeje e publikut me teatrot të ndryshme. Shihet që këtu ka pamje nga bulevardi, nga hapësira e brendshme. Është makineria e madhe e shfaqjeve dhe me hapësirë.

9. Në pjesën e pasme ka pjesën e administratës dhe në pjesën e anësore ka edhe hapësira për artistë dhe regjisorë. Ka edhe hapësira të çatisë dhe një lloj harku, pra një tuel hyrës dhe dalës, nga ku shihet edhe rruga. Pra, këtu ekspozohen shkallët e skenave, që mund të jenë krejtësisht të hapura nga harku. Kjo është pjesë e njollës së zhvillimit në këtë hapësirë, si hapësira publike, restorantet, dyqanet e vogla, që na bëjnë të hyjmë tek pjesa e teatrit. Është transparent, ka hapësirë për ndenjen e njerëzve.

10. Plani më nga afër sheh për nga muzeu, për nga parku. Imagjinoni në mbrëmje këto vende shërbejnë për koncerte, apo shfaqje të caktuara. Duket sikur je në një urë. Ke dy teatro eksperimentale. Një skenë kryesore që përbëhet nga një material i butë që ofron një hapësirë ideale. Këtu mund të shihet xhamia e re në sfond. Është një nga hapësirat më të bukura, që natyrisht mund të shkohet edhe në çati.

11. Do të doja që t'ju shpjegoja disa gjëra. Kjo është fasada. Kjo është për të krijuar harkun ku mund të bëhen shfaqje. Është si lidhja e një fngjoje, ose e një perdeje në skenë. Fasada është me beton të bardhë të cilësisë së

lartë. Në anën e majtë është një referencë nga një ndërtime katalanjas, ku përdoret një copë vetëm për betonin. Kjo do japë një ide të perdes së prezantuar me një material të ngurtë. Shihet harku dhe si futen njerëzit brenda. Pjesa e mesit është lobi kryesor, salla kryesore e shfaqjes dhe pjesa e barit që keni nga qyteti. Pjesa nga hapësira e brendshme mund të bëhet një hapësirë publike. Në Tiranë nuk bie shumë shi dhe kjo është një pjesë miqësore.

12. Një pjesë e fasadës është si një shtëpi kullë, ku shihet një pjesë e brendshme jashtë. Në pjesën e paraskenës do të keni mundësi të shihni pjesën e pasme të skenave dhe të shini momentet ku bëhen provat. Kjo është e bukur për ata njerëz që duan të bëhen regjisorë, koreografë etj. Por përmes perdeve, për të ruajtur privatesinë, kur duhet.

13. Shihen përmes parkut, përmes resë, ballkone të ndryshme. Kjo nënkupton se kjo ndërtesë nuk do të jetë një ftesë vetëm për ata njerëz që po blenë biletën për të parë teatër, apo mund të frymëzohet që të hysh në teatër, por si një ftesë për pjesën tjetër të qytetit. Dhe në qoftë se nuk ke biletë për të parë një shfaqje, kjo është një ftesë për të gjithë ata që mund dhe duan të lëvizin në qendër të Tiranës.

SI DO TË JETË TEATRI I RI KOMBETAR

Projekti i ri ndërtohet aty ku sot ndodhet Teatri Kombëtar ekzistues, me hyrje përmes shëtitores "Murad Toptani". Godina ndahet në dy pjesë; njëra për aktorët dhe administratën, pjesa tjetër për publikun me funksion kryesor atë të teatrit dhe të dyja pjesët kanë akses të veçanta. Publiku do të ketë hyrjen nga fasada kryesore, ose një hyrje tjetër poshtë harkut. Pjesa e çatisë së ndërtesës do të shërbejë gjithashtu si një teatër i hapur/auditor, ku publiku mund të ulet në shkallare për aktivitetet e ndryshme.



DËGJESA PËR TEATRIN

Fatmira Nikolli

Tan Imami, Veliajt: Asnjë copë truall i teatrit te privati

Neritan Liçaj braktis dëgjesën: Anuloni projektligjin pastaj negociojmë, Veliaj: E urdhëroi partia

Artan Imami: Prona që posedon Teatri Kombëtar duhet të shfrytëzohet vetëm dhe vetëm për godinën e re

Është zhvilluar dje një dëgjesë e dytë me artistë e arkitektë për çështjen e Teatrit Kombëtar me nismën e Bashkisë së Tiranës. Gjatë dëgjesës, artistët ishin sa të ndarë në qëndrimet e tyre, po aq të bashkuara në idenë e mostjetërimit të truallit. Një pjesë që protestojnë prej muajit shkurt kanë kundërshtuar shembjen e godinës aktuale të Teatrit dhe kanë kërkuar fuqimisht anulimin e projektligjit që i hap rrugë një kontrate PPP mes bashkisë dhe privatit për një godinë të re për teatrin. Një pjesë tjetër e artistëve, që kanë marrë pjesë në mënyrë sporadike në takimet për çështjen kanë mbështetur idenë e një teatri të ri, por dukë mos lejuar që asnjë pjesë e truallit të TK të përdoret nga privati.

Kryebashkiaku Erion Veliaj nga ana tjetër, bëri edhe akuza politike në drejtim të anëtarëve të Aleancës për Mbrojtjen e Teatrit, duke përmendur emra që sipas tij, komandohen nga Partia Demokratike, megjithëse akuza u përgjeshtrua më vonë nga PD.

VELIAJ

Kryebashkiaku tha dje se ka mbledhur artistë, arkitektë dhe urbanistë për t'i dhënë Tiranës një Teatër Kombëtar dinjitoz. Veliaj shprehu bindjen se kushtet në të cilat gjendet sot godina e teatrit nuk mund të mirëpresë asnjë aktivitet të rëndësishëm. "Nëse do të kishte një institucion të ngjashëm si UEFA edhe për teatrin, godina aktuale nuk do të mund që të certifikohet për standardet që ajo ofron aktualisht. Do të doja shumë që ne të planifikojmë një ekspeditë dhe një vizitë në stadiumin kombëtar. Pse e përmend çështjen e stadiumit kombëtar, jo vetëm sepse është një koncept i ngjashëm me propozimet, por, sepse besoj ka një logjikë që ngjan me teatrin", -tha kreu i Bashkisë së Tiranës. Sipas tij, shumëkush mund të thotë çfarë lidhje ka sporti me teatrin. "T'u bëj një analogji. Një nga arsyet pse na nxitin të bëjmë stadiumin kombëtar është sepse UEFA tha këtu nuk mund të luhen ndeshje ndërkombëtare, do të thotë që ekipi i Shqipërisë do të duhet të shkotojë të luante jashtë, për analogji po pyes: Kur ka qenë festivali i fundit ndërkombëtar që është zhvilluar në TK? Kur kanë ardhur aktorët në të mëdhenj në Evropë për të bërë një shfaqje teatrorë me standard në TK? Pra, pyetja është kjo: është për diskutim nëse do kishte një UEFA për TK do të certifikonte këtë teatër? Si një trupë ku



mund të vijë të luajë një trupë e Moskës, e Pragës, Londrës, një trupë e New York? Pra, po të kishte UEFA për teatër do certifikoheshim ne të bënim kampionatin evropian të teatros në Tiranë me këto kushte ku jemi sot? Unë besoj që këto janë pyetje që duhet t'i përgjigemi", -tha Veliaj.

ARTAN IMAMI

Aktori Artan Imami si në takimin e mbajtur me ministrin Mirela Kumabro në shkurt në ministri, edhe dje u shpreh por ndërtimit të një teatri të ri. Në këtë rast, ndryshe nga muaji shkurt, Imami kërkoi që të ruhet e gjithë sipërfaqja.

"Ajo që dua të deklaroj është që të gjitha ata që do

e gjejnë veten në këtë deklaramund të firmosin goftë virtualisht goftë me qëndrimet e tyre publike. Ne artistët e pavarur, të cilët nuk jemi pjesë e asnjë shoqate, apo grupi artistësh apo anëtarë sindikatash, të cilët gëzojmë po të njëjtat të drejta në lidhje me godinën e Teatrit Kombëtar dëshirojmë që t'i bëjmë me dije gjithë opinionit publik dhe dashamirësve të teatrit në vendin tonë se: Shprehim dakordësinë tonë dhe nevojën emergjente për një godinë të re të Teatrit Kombëtar", -tha Imami.

Sipas tij, kërkohet "një godinë, e cila t'u shërbejë artistëve dhe mbi të gjitha publikut, i cili edhe pse në



kushte tërësisht të papërshtatshme për asnjë moment nuk e ka braktisur skenën e teatrit. Ne artistët nënkruar të kësaj deklarate shprehim vullnetin dhe njëkohësisht edhe kërkesën tonë në funksion edhe të transparencës që i shërben forcimit të besimit në këtë proces, përfshirjen e detyrueshme në komisionin e negociimit që do të ngrihet për zhvillimin e këtij projekti me qëllim për të qenë pjesë e vendimarrjes që ka të bëjë për ngritjen e godinës së re të Teatrit Kombëtar".

Imami theksoi se "shprehim mendimin tonë paraprak, para nisjes së negociatave se prona që posedon

Teatri Kombëtar duhet të shfrytëzohet vetëm dhe vetëm për godinën e re të Teatrit Kombëtar duke mos cenuar tjetërsimin, nënvizoj, duke mos cenuar tjetërsimin e asnjë pjesë të kësaj prone apo vendosjen e saj në favor të partnerit privat për zhvillimin e pjesës tjetër të projektit".

Sipas Imamit, teatri është një institucion kombëtar dhe për këtë arsye ne artistët kërkojmë një proces transparent duke qartësuar ju vetëm grupin tonë të artistëve, por edhe gjithë publikun në lidhje me procesin e nisjes së ndërtimit dhe afatin konkret të përfundimit të kësaj godine dhe vënien e saj në funksion të



publikut. "I gjithë ky proces kërkon një bashkëndim dhe mbi të gjitha besim midis palëve për të ngritur më në fund një godinë bashkëkohore dhe moderne të Teatrit Kombëtar në shërbim të artistëve dhe publikut tonë artdashës. I ftoj të gjithë ata që e gjejnë veten brenda këtij deklarimi, do ta gjejnë në ueb, të thonë mendimin e tyre publikisht", -shtoi Imami.

LIÇAJ

Aktori Neritan Liçaj mori pjesë në dëgjesën e Veliajt, në emër të Aleancës për Mbrojtjen e Teatrit. Si i tillë, ai theksoi se është kundër shembjes së Teatrit dhe në fund të fjalës u largua.

"Aleanca Qytetare për Mbrojtjen e Teatrit Kombëtar me përgjegjësi të lartë qytetare i bënë me dije çdo qytetari të Republikës kudo ai ndodhet se nuk ka dhe nuk do të ketë asnjë konsensus me askënd sa kohë nuk tërhiqet projektligji, i cili grabit tokën publike të Teatrit Kombëtar. Teatri Kombëtar dhe prona

Koordinatorja e PD? Kush është Taulanda Jupi dhe pse Veliaj tha: I komandon partia

Fatmira Nikolli

Pas fjalës së mbajtur, Neritan Liçaj si përfaqësues i Aleancës për Mbrojtjen e Teatrit, e la dëgjesën e Veliajt. Vetë Aleanca nuk e njeh Veliajn si përfaqësues të qeverisë për negociatën, ndërsa bisedimet janë anuluar për shkak se artistët kanë kërkuar së pari, tërheqjen e ligjit që i hap rrugë shembjes së teatrit.

"Ne si artistë nuk e njohim kryetarin e Bashkisë si autoritetin e ligjshëm me të cilin mund të negociojmë për këtë çështje. Sa kohë është iniciuar një projektligj, autoriteti i cili duhet të reflektojë është autoriteti që ka propozuar projekt-ligjin për tjetërsimin e pronës publike. Aleanca Qytetare për Mbrojtjen e Teatrit Ko-



mbëtar i bënë thirrje Kryeministrit të vendit të dalë në shesh e të përballet, ai duhet ta dijë mirë që ka përballet, ai duhet ta dijë se i vetmi dialog që mund të zhvillohet, do zhvillohet me

qeverinë, dhe në kushtet e tërheqjes së projekt-ligjit", thuhej në deklaratën e Aleancës për Teatrin.

Për ç'arsye, siç patën njoftuar që më herët drejtuesit e protestës së

artistëve, Liçaj braktisi takimin me të mbaruar fjalën. Por, pas largimit të tij, Veliaj u shpreh se kish të urdhër nga partia për të bërë një gjë të tillë duke e cilësuar si fyese.

"Unë e pashë fotografimin në celular, që i thanë 'Ik prish mbledhjen' dhe do ta publikoj. Para se të fliste Neritanin e kam saktësisht porositë e partisë dhe do ta botoj. Por e kam zgjedhur vetë të bëj këtë rol. Të moderorit, edhe pse i di të gjitha. Sot do bëj një dëgjesë qytetare. Kjo ndarje e artistëve është fyese", -tha Erion Veliaj. Pak minuta më vonë, ai publikoi një komunikim mes avokates Mirela Jorgo dhe artistes Taulanda Jupi. Media më pas e quajti Jupin përfaqësuese të Partisë Demokratike dhe koordinatore të çadrës së PD-së. Por kush

është Jupi? Përtej angazhimeve që ka pasur më herët, gazetaret që e kanë ndjekur protestën prej muajit shkurt, e dinë se ajo ka qenë në çdo takim të artistëve në këta pesë muaj.

Pas deklaratave të kreu të bashkisë Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit tha se "Sot është publikuar një komunikim me mesazhe drejtuar avokates Mirela Cela Jorgo, nga anëtarja e Kryesisë së Sindikatës së Artistëve të Skenës dhe Ekranit (SASE) Taulanda Jupi, gjatë dëgjesës së thirrur nga z. Veliaj me artistë e arkitektë. Media të ndryshme, kanë raportuar se Taulanda Jupi ka qenë koordinatore e çadrës së PD. Nuk është hera e parë që zonja Jupi përgjohet nga media pranë pushtetit. Shpifje të ngjashme i janë drejtuar edhe anëtarëve të tjerë, Kastriot Çipi e Robert Budina, pas takimit të tyre me Bashën", -thuhet në deklaratë. Sipas Aleancës, "shumë çuditërisht (ose aspak çuditërisht) këto media



ku ai ngrihet është pasuri publike në aspektin ligjor dhe shpirtëror ndaj sigurojmë qdo qytetar se do e mbrojmë pa asnjë lëshim”, tha Liçaj në emër të Aleancës. Ai shtoi se komuniteti i aktorëve, Shoqërisë Civile dhe qytetarëve të angazhuar që janë bashkuar në qëndrueshmëri mbrojtjen e Teatrit Kombëtar kërkon dialog dhe bisedime konstruktive për rikonstruksionin e godinës aktuale si një vlerë dhe kujtesë historike.

“Gjithashtu, jemi të hapur për ndërtimin e një godine të re Teatri bashkëkohor në një vend tjetër publik me para publike. Jemi të gatshëm të ulemi dhe të gjejmë formulën se si mund t'i vijmë në ndihmë shtetit për mbledhjen e fondeve të kërkuara. Aleanca Qytetare për Mbrojtjen e Teatrit Kombëtar iu përgjigj pozitivisht thirrjes së parë për bashkëbisedim, por hasëm në përdorimin politik dhe manipulimin publik nga ana e qeverisjes vendore dhe qendrore duke

gjuajtur nën brez”, -theksoi Liçaj.

Sipas tij, të vetëdijshëm për detyrën e lartë morale që kemi karshi qytetarëve, të qartë se interesi jonë është publikja dhe jo llogaritë e pushteteve, të kthjellët për çfarë rreziku na kanoset, me vetëdije të lartë qytetare dhe të vendosur i bëjmë me dije publikut se nuk do e lejojmë dhe nuk do e japim konsensusin për prishjen e Teatrit Kombëtar dhe tjetërsimit të Pronës Publike.

“Bëjmë thirrje për rivendosjen e dialogut. Ka vetëm një rrugë që palët të mund të fillojnë të flasin. Ka vetëm një kusht që nuk e negociojmë. Të tërhiqet projekt-ligji. Mos luani me publikun, mos luani me Teatrin Kombëtar, sepse ne e kemi ndarë mendjen për rezistencë shembullore. Mos, sepse do ketë kosto të paktyeshme për marrëdhënien mes komunitetit tonë dhe politikës”, -theksoi Neritan Liçaj.

SHOQATA E ARKITEKTËVE

Po dje, Shoqata e Arkitektëve të Shqipërisë, ka dalë me një qëndrim publik. Duke përmendur nevojën për një teatër të ri, shoqata thotë se nuk pajtohet me prishjen e vlerave historiko-arkitektonike të qytetit e të memories së brezave të tërë.

Ata propozojnë që teatri i ri të vendoset në krah të bulevardit të ri, duke u bërë fillesa e një “La Defense” Tiranase për kryeqytetin tonë. “Duke u ndërtuar në një parcelë me sipërfaqe të bollshme ai mund të projektohet duke përbushur të gjithë parametrat e një strukture moderne të pa kushtëzuar nga njolla e kufizuar e ndërtimit, e cila u tha se do të respektohet nëse teatri i vjetër do të prishet. Të ketë sheshin e parkimin e tij, hapësirat e gjelbra dhe rekreative e pse jo edhe të përfitojë nga një sipërmarrje e tipit PPP me pronarët e truallit, për t'u rritur në madhësi e cilësi”.

nuk e kanë akuzuar z. Çeloallaj si anëtar të PS, pas takimit të tij me z. Veliaj, në të njëjtën tavolinë ku kolegët e tij kishin takuar më parë z. Basha”. Për sa më lart, SASE sqaron opinionin publik se:

Anëtarësia në një parti politike, nuk është kusht përjashtues për anëtarësinë e individit në një sindikatë. Megjithatë, asnjë nga anëtarët aktualë të Kryesisë, të zgjedhur me votim të fshehtë, në një proces transparent, më 27 mars 2018, nuk është anëtar i ndonjë partie politike. Aleanca fiton median të publikojë çdo informacion konkret që ato mund të disponojnë ose zbulojnë në të ardhmen, mbi përkatësinë partiake të secilit prej 5 anëtarëve të kryesisë, që janë Alert Çeloallaj, Robert Budina, Kastriot Çipi, Taulanda Jupi dhe Besmir Bitraku”-shënon, Kryesia e Sindikatës së Artistëve të Skenës dhe Ekranit.



EMERGENCË, PËRMBYTET BIBLIOTEKA KOMBËTARE, LAGEN 12 MIJË NJËSI

Ndërsa Opera është në rikonstruksion, e Teatri Kombëtar në zgrip të mbijetesës mes protestash e kanosjes për t'i vënë kuzmën, krahas sheshit “Skënderbej”, është përmbytur edhe Biblioteka Kombëtare. Lajmin e ka konfirmuar vetë ajo përmes një komunikate për mediat ku bën me dije se 12 mijë njësi bibliotekare janë dëmtuar nga uji.

“Biblioteka Kombëtare njofton se në orët e para të datës 23 qershor 2018, mbas reshjeve të vrullshme të shiut, është konstatuar prani uji në një nga sallat e saj në katet e nëndeshme të hapësirave deponituese të koleksioneve bibliotekare (libra, revista, gazeta), duke dëmtuar/lagur materialet bibliotekare të sistemuara në nivelet e ulta të sallës”, thuhet në komunikatën e shpërndarë me media.

Më poshtë sqarohet se “institucioni shpalli gjendjen e emergjencës për trajtimin e materialeve bibliotekare të lagura ose pjesërisht të lagura me

qëllim tharjen dhe restaurimin e tyre të plotë”. Biblioteka Kombëtare thekson se nuk janë prekur mjediset ku ruhet fondi i Vlerave të rralla dhe Arkivi i librit e i periodikut shqip.

“Nga të dhënat paraprake, numri i njërive bibliotekare me gjurmë lagështire rezultoi rreth 12 mijë. Gjatë punës së deritanishme janë tharë plotësisht rreth 70% e tyre. Vijon puna intensive për tharjen e plotë të pjesës së mbetur”, shton komunikata. Sipas saj, mbizotërojnë tekstet mësimore dhe botime të 15 viteve të fundit, të cilat për shkak të mungesës së theksuar të hapësirave deponituese nuk kanë mundur të ruhen sipas standardeve



tekniko-profesionale. “Në funksion të kësaj emergjence dhe në respek-

tim të protokolleve profesionale, njoftojmë se Biblioteka Kombëtare do të qëndrojë e mbyllur nga data 25 deri 30 qershor”, përfundon njoftimi.

Kujtojmë se në datë 15 mars 2017, Biblioteka Kombëtare u përfshi nga flakët, zjarri ra në katin e nëndeshëm, ndërsa u dëmtuan disa materiale, ndërsa para dy ditësh e njëjta hapësirë u përmbyt nga reshjet e shiut.



ÇABEJ NË GUR PARA AKADEMISË SË SHKENCAVE

Busti i gjuhëtarit dhe Balbanologut të zëshëm shqiptar Eqerem Çabej është vënë dje në para kopshin e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Në ceremoninë e inaugurimit ishte i pranishëm edhe kryeministri Edi Rama, që pos vlerësimit për figurën madhore të gjuhës shqipe, çmoi edhe realizimin e skulpturës nga Hektor Dule. Inaugurim i bustit të Eqerem Çabejt sjell kryeministrin e Shqipërisë mes akademikëve. Edi Rama e cilësoi si një prej fjalimeve më të vështira që ka mbajtur; pasi sipas tij, i rëndon pesha dhe madhështia e Çabejt. “Është një rast posaçërisht i veçantë, që sprovon të gjithë eksperi-



encën e fjalëve të mbajtura përpara njerëzve, pasi, të flasësh shqip, për të ndëruar një njeri aq të bukur sa Eqerem Çabej, përkushtimi

dhe kontributi i të cilit për shqipen e ktheu përjetësisht në lartmadhërinë e shkencave albanologjike, është një sfidë më vete”, tha kryemi-

nistri.

Nga ana tjetër, veprën e skulptorit Hektor Dule e çmoi për realizimin dhe e krahasoi për një nivel me krahasoi për një nivel me bustin Naim Frashërit e realizuar nga Odise Paskalin. Skulptori thotë se rikthimi në ambientet e Akademisë së Shkencave pas 63 vitesh me një figurë kaq madhore, nuk ka qenë i lehtë. Synimi i tij, ku ishte forcës së mendimit. Ai rrëfen se për realizimin e këtij busti ka shfrytëzuar edhe njohjen me Çabejn, së bashku me një foto të shkrepur prej tij po në këtë pozicion. Nga ana tjetër, kryeministri Edi Rama thotë se ka ardhur koha që t'i rikthehet doktoratura e Çabejt publikut në lidhje me etimologjinë e shqipes. Në kopshin e Akademisë së Shkencave bus-

Opinion i Ditës

Si e zhvlerësoi Macron bastin e Ramës

Nga Andi Bushati

(vijon nga faqja 1)

...të azilantëve në vend. Në një status të shkurtër ai ka sulmuar "esadistë-t" në politikë dhe media, që ndezën idenë e paqenë, të cilën e hodhi poshtë edhe samiti i së dielës në Bruksel, ku morën pjesë vetëm 16 prej vendeve anëtare.

Pra, sipas Ramës, nuk ka pasur kurrë një përpjekje për të sjellë refugjatë në Shqipëri dhe kjo është një shpikje e "kazanit" vendës. Në fakt, nuk është aspak kështu dhe Rama gënjen ditën për diell. Deri në mbledhjen e djeshme të krerëve të qeverive të BE (pa shtetet e grupit të Vishegradit dhe ato baltike) opsiioni për të ngritur kampe refugjatësh jashtë kufijve të BE-së ka qenë prezent. Vende si Austria dhe Danimarka kanë bërë propozim zyrtar për këtë. Edhe Gjermania e Merkelit, ku kancelares po i rrezikohet seriozisht pushteti nga çarja e mundshme e koalicionit të CDU-së me krahu bavarez me ksenofob të CSU-së, të përfaqësuar nga ministri i brendshëm, Horst Seehofer, në kalamend gjatë për këtë zgjidhje. Fakti që ajo ka qenë një opsion serioz në tavolinë e tregojnë edhe fjalët e presidentit francez, Emanuel Makron, i cili tha pas gjysmësamitit të djeshëm se "u eliminuan zgjidhjet që binin ndesh me vlerat tona". Pra, kjo nuk është shpikje e "esadistëve" shqiptarë. Cfarëdo që të thotë Edi Rama tani, pranohet nga të gjitha kancelaritë dhe mediat europiane se BE u fut në një krizë të thellë



që pas 10 qershorit, kur ministri Brendshëm italian (i ekstremit të djathtë) Mateo Salvini, vendosi të mbyllë portet e vendit të tij për emigrantët. Më tej homologu gjerman, Horst Seehofer i CSU deklaroi se nuk do të hezitonte ta linte të rrezohej kancelaren Merkel, nëse ajo nuk i ashpërsonte politikën migratore. Po t'i shtosh këtyre edhe faktin se kryeministri austriak, Sebastian Kruz, që i ka lënë çelësat e Ministrisë së Brendshme në duart e një neo-nazisti, proklamoi krijimin e një "aksi të vullnetit të mirë" kundër

emigrantëve (Itali, Gjermani, Austri), zgjidhja e problemit përmes kampeve të refugjatëve ishte më e prekshme se kurrë. Por, manipulimi i Ramës nuk qëndron vetëm në faktin se e mohon atë. Ai shkon edhe më tej, ai hiqet sikur Shqipëria nuk ka pasur kurrë lidhje me këtë histori. Në fakt, është krejtësisht e kundërta. Pas krijimit të kësaj situatë, emri i vendit tonë u përmend pothuajse përditë në të gjitha mediat europiane. Fillimisht ai u çiftëzua me Tunizinë – si një bazë tjetër e mundshme, por pas refuz-

imit të saj, Shqipëria mbeti e vetme. Në këtë histori ka edhe më. Sepse, sipas të gjitha indicieve, pasi ka parë krizën e madhe ku ishin futur vendet e BE-së, Rama ka dalë vullnetar të luajë rolin e zjarrfikësit. Ai është vetëpropozuar për t'i ngritur kampet e refugjatëve në Shqipëri. Jo më kot, në kulmin e këtij debati, zvmministri i Brendshëm, Julian Hodaj, i tha pikërisht një medie gjermane, televizionit "ZDF", se Shqipëria ka kapacitet të mirëpresë deri në 600 mijë refugjatë. Madje, në një nismë aspak në kokë të vet, ai këmbën-

guli se vendi e ka jetuar këtë eksperiencë që në kohën e luftës së Kosovës. Një fakt edhe më i fortë pro vullnetarizimit të Ramës është edhe intervista për "Deutsche Welle" -n e deputetit gjerman, Johann Wadepful, i cili pranoi me gojë plot se propozimi për kampe refugjatësh i është bërë qeverisë gjermane nga vetë ministri i Brendshëm Xhafaj gjatë një qëndrimi disaditor në këtë vend. Pra, është e qartë se më s' bëhet, se ideja për të ngritur kampe refugjatësh në Shqipëri nuk ishte një shpikje e "esadistëve" lokalë. Mediat dhe kancelaritë perëndimore folën gjatë për të, sepse Edi Rama vuri bastin e madh që me këtë koncesion, të fshihte problemet me drogën, korrupsionin dhe autoritarizmin. Natyrisht, ai e humbi këtë bast, as për ndonjë gabim dhe as për ndonjë meritë të tij. Thjesht në samitin e 16 vendeve të BE, të dielën në Bruksel, doli fituese ideja e presidentit Macron dhe kryeministrit të ri të Spanjës, Sañchez, se kjo zgjidhje do të që një turp për vlerat e kontinentit të vjetër: Kështu u rrëzua, së paku përkohësisht, mundësia e ngritjes së hot spotëve për azilkërkuuesit jashtë kufijve të Bashkimit Europian. Dhe me rrëzimin e këtij versioni, liderit global, i humbi edhe mundësia të luante rolin e shpëtimtarit të Evropës. Prandaj tani atij s' i mbetet tjetër gjë, veçse të fshehë kokën në rërë si struci dhe të pretendojë se ajo që kanë parë dhe dëgjuar të gjithë është shpikje e kazanit gjithnjë e më të madh të armiqve të vet.

"Lapsi.al"

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

MERRNI NE KOHE REALE
LAJMET E FUNDIT NE
APARATIN TUAJ



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

Dje në "Reuters"

Tri vende të BE kundër hapjes se negociatave me Shqipërinë

Nga Robin Emmot

(vijon nga faqja 1)

... teksa ndjenja anti-emigracioni rritet në bllok, por NATO është gati të mirëpresë Shkupin në aleancën ushtarake perëndimore.

Me mbështetjen e gjerë për hapjen e bisedimit e anëtarësimit nga qeveritë e tjera të BE dhe Komisionit Europian, Shqipëria dhe Maqedonia shpresojnë që ministri të Europës të bien dakord gjatë takimit të së martës në Luksemburg, që do të hapte rrugën për aprovim nga krerët e qeverive të BE në një samit të enjtes.

Megjithatë, Franca dhe Holanda, me mbështetjen e Danimarkës, po rezistojnë dhe mund të kërkojnë kushte të mëtejshme, të tilla si më shumë reforma për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar në Shqipëri dhe Maqedoni, thanë zyrtarët e BE.

Pasi Maqedonia dhe Greqia zgjidhën një mosmarrëveshje të vjetër rreth emrit që kishte bllokuar procesin e anëtarësimit në BE, hapja e bisedimeve do të shënonte hapin më të qartë deri tani në përpjekjet e bllokut për të rinovuar zgjerimin e saj me gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor pas viteve të neglizhimit të rajonit.

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg tha se aleanca e udhëhequr nga Shtetet e Bashkuara ka gjasa të miratojë bisedimet e anëtarësimit me Maqedoninë në një samit në korrik. Shqipëria tashmë është pjesë e NATO-s dhe anëtarësi është provuar të jetë një platformë për t'u bashkuar me BE.

"Unë pres dhe shpresoj që krerët e shteteve dhe qeverive të mund të bien dakord për të filluar bisedimet e pranimit", tha Stoltenberg ndër-sa arriti për një takim të përbashkët të ministrave të Mbrojtjes dhe të Jashtëm të BE-së në Luksemburg.

Ai tha se marrëveshja me Greqinë për të ndryshuar emrin nga ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë në Republika e Maqedonisë Veriore ishte "një marrëveshje historike që ofron një mundësi historike" për Shkupin për t'u bashkuar me NATO.

Presidenti francez Emmanuel Macron i tha Parlamentit Europian në prill se ai nuk mund të mbështeste zgjerimin e BE nëse më parë nuk realizohen reforma të brendshme të bllokut, dhe diplomatët thonë se pozita franceze nuk ka ndryshuar.

Diplomatët të tjerë thonë se thëlbij janë shqetësimet e emigrimit.

"Reformat priten para se të mund të hapin negociatat, sepse kemi një nivel të lartë të kërkesave", tha një burim diplomatik



francez.

Franca dhe Holanda i dërguan një letër qeverive të tjera të vendeve të BE-së, ku thuhej se mungesa e reformave gjyqësore, korrupsionit tipik dhe krimi i organizuar ishin arsye pse Shqipëria dhe Maqedonia nuk ishin gati për bisedimet e anëtarësimit në BE, sipas diplomatëve.

"Pikëpamja e tyre është se kushtet për hapjen e negociatave nuk janë", tha një diplomat i BE.

Dy diplomatët të tjerë të BE dhe zyrtarë të BE thanë se shqetësimi më i thellë i Macron ishte se hapja e bisedimeve të anëtarësimit me Shqipërinë dhe Maqedoninë do të përdorej nga politikanët e ekstremit të djathtë, të cilët po

marrin mbështetje me premtimet populiste për të ndaluar migracionin – duke përfshirë nga vendet relativisht të dobëta të Europës Lindore te vendet më të begata të Europës Perëndimore.

"Macron mendon se kjo hap një krah për politikanët e djathtë për shkak të reputacionit të krimit të organizuar në Shqipëri. Ata nuk duan të hapen (bisedimet për anëtarësimin) para zgjedhjeve europiane vitin e ardhshëm", tha një zyrtar i BE i cili kërkoi të mos identifikohet, duke iu referuar votimit të ardhshëm të majit për Parlamentin Europian.

Shefi ekzekutiv i BE, Jean-Claude Juncker, i cili vizitoi Shqipërinë, Bosnjën, Kosovën, Maqedoninë, Malin e Zi dhe Serbinë në mars, ka paralajmëruar se Ballkanit mund të përballet me një kthim në luftë pa asnjë shpresë për t'u bashkuar me bllokun.

Të gjashtë vendet konsiderohen anëtare të ardhshme.

Largimi i menjëhershëm i Britanisë nga BE dhe oferta e papraturuar e anëtarësimit nga Turqia, e shtyu Komisionin të propozojë një intensifikim të bisedimeve të pranimit me Ballkanin Perëndimor, edhe nëse kandidatët më të avancuar, Serbia dhe Mali i Zi, nuk kanë gjasa të bashkohen para 2025-ës.

Nërkohë që Gjermania ndan shqetësimet franceze në lidhje me fillimin e bisedimeve me Shqipërinë dhe Maqedoninë, Kancelarja Angela Merkel ka vendosur të mbështesë zgjerimin për arsye gjeopolitike dhe për të kundërshtuar rritjen e ndikimit rus dhe kinez në rajon.

"Franca duhet të shohë dimensionin strategjik të afimit të Ballkanit Perëndimor me BE", tha një burim i qeverisë gjermane për Reuters duke shtuar: *"Ne argumentojmë se bisedimet e hapjes nuk janë mbyllja e negociatave të pranimit"*.

Presidenti francez Emmanuel Macron i tha Parlamentit Europian në prill se ai nuk mund të mbështeste zgjerimin e BE nëse më parë nuk realizohen reforma të brendshme të bllokut, dhe diplomatët thonë se pozita franceze nuk ka ndryshuar.

HOROSKOPI

DASHI

Dilni nga kllapia dhe veproni menjëherë, nëse nuk doni që të ngelni mbrapa. Gjë që nuk është kushedi se çfarë, zakonisht. Për të gjetur çelësin e problemit, nevojitet që të keni qetësinë e duhur mendore dhe të mos shpejtoni.

DEMI

Ndryshime të shpejta dhe pozitive, me bashkëveprimin e Diellit me Hënë që ju favorizojnë. Në vazhdim e vendimeve të marra, popullariteti juaj do të pësojë një rritje! Pak krijimtari dhe fantazi në profesion do t'ju sjellë vlerësimin e një eprori.

BINJAKET

Një ditë pa shumë bujë. Nëse mendoni se meritoni më shumë, nuk keni bërë llogaritë me ata me të cilët duhet të ndani meritat. Në fund do të dini si ta menaxhoni situatën, pasi nuk doni që të dilni keq.

GAFORJA

Planetet do të bëjnë që sot të ndiheni më materialistë sesa zakonisht. Por fatmirësisht pozicionin i Uranit do t'ju ndihmojë që të çlirohni fantazinë. Ndoshta zgjedhja që do të bëni nuk është ajo që do të pritej nga ju: po përdorni imagjinatën.

LUANI

Keni të bëni me qeshje të brendshme dhe familjare të pazgjidhura, dhe mund ta shfaqni shumë sesa duhet nervozizimin. Përpunoni ndërkaq të një mirëkuptueshmë. Mund të gjeni gjithnjë një pikë të përbashkët dhe të arrini kështu në një kompromis me të gjithë.

VIRGJERESHA

Shfrytëzoni favorizimin që planetët kanë për të zmadhuar dhuntitë tuaja dhe të përdorni çdo mënyrë për të vënë në vijë punët tuaja. Nganjëherë nuk duhet të lodhni shumë për të rënë në sy, mjafton të zgjidhni me kujdes mundësinë më të mirë.

PESHORJA

Ata që varen nga ju nuk bëjnë punën e tyre ashtu siç prisni, qortojni sigurisht, por pa e bërë të madhe. Nuk keni arsye përse ta bëni. Me mirë thuajini gjërat siç janë, pa shumë lojë fjalësh, në mënyrë të qartë, të drejtëpërdrejtë dhe të saktë.

AKREPI

Sot do të do të vini në jetë ide nisimtare. Jeni të palodhshëm, të aftë për të punuar pa ndalur. Nganjëherë, megjithatë, nuk e kuptoni që e tejkaloni masën. Një ofertë pune duket shumë premtuese. Çfarë prisni për ta pranuar? Mos humbni kohë!

SHIGJETARI

Nëse në të kaluarën keni marrë një ndihmë të papritur, tani është koha ta ktheni favorin pa u tërhequr mbrapsht. Në fund edhe ju do të shpërbleheni. E rëndësishme është t'ia nisni mbarë: nganjëherë gatishmëria vlen, në disa raste, më shumë se çdo gjë tjetër.

BRICJAPI

Kujdes nga kokëfortësia, sepse mund të sjellë gjëra të pakëndshme. Me mirë të udhëhiqeni nga dikë që ka më shumë përvojë sesa ju. Përvoja ju mëson, por nëse nuk jeni të sigurt për diçka njëqind për qind, nuk duhet as ta provoni.

UJORI

Mos u hidhni shumë përpjetë, nëse nuk doni të rrezikoni! Duhet të qëndroni me këmbë në tokë dhe të mos përfshihen nga aventura tepër të rrezikshme. Mendoni për pasojat e veprimeve që kryeni, do të shmangini rrezikun për ta pësuar.

PESHQI

Nëse po shqyrtoni mundësinë për një udhëtim, për argëtim apo për punë, mos u ktheni mbrapa. Parashikohen përvoja shumë interesante në vijim! Mund të pasuroni bagazhin tuaj kulturor me njohje dhe njohuri të reja. Me të vërtetë shumë mirë.



Xhaka dhe Shaqiri i shpëtojnë pezullimit, ia hedhin me gjobë

Festa me shqiponjë, FIFA shpërfill Serbinë

Shqiponja mund të jetë fobi për serbët, por jo për FIFA-n. Nuk ka dënim për Granit Xhakën dhe Xherdan Shaqirin, FIFA nuk merr parasysh kërkesën e federatës serbe për pezullimin e dy futbollistëve të përfaqë-

sueses zvicerane, duke i ndëshkuar vetëm me gjobë. "Për shkak të shkeljeve të nenit 57 të kodit disiplinor të FIFA-s dhe sjelljeve josp sportive në kundërshtim me fair-play gjatë festimit të golave në takimin Zvicër-Serbi, loj-

tari Granit Xhaka dënohet me 10 mijë franga zvicerane, Xherdan Shaqiri dënohet me 10 mijë franga zvicerane dhe Stefan Lihstajner me 5 mijë franga". Ky është vendimi i FIFA-s për çështjen më të bujshme në këtë

Botëror, vendim ky i bërë publik nga e përditshmja zvicerane "Blick". Ashtu siç pritej, federata serbe nga akuzuesi u kthye në të akuzuar, teksa FIFA e ka dënuar me 54 mijë franga zvicerane për shkak të flakëve dhe mesazheve diskriminuese që shfaqën tifozët e tyre në shkallët e stadiumit. Me gjobë është dënuar edhe trajneri i përfaqësueses serbe për deklaratat e dhëna pas përfundimit të sfidës.

Kuarezma kalon në avantazh portugezët, ndërsa më pas gjyqtari paraqian komplikon gjithçka

VAR-i bën lëmsh Iranin, kalojnë grupin Spanja dhe Portugalia

Maroku ndal "Furia Rojan" në një barazim 2-2



Jeton Selimi

Portugalia është kualifikuar pas një barazimi 1-1 ndaj Iranit, duke marrë vendin e dytë në grup, por ndeshja mes dy skuadrave do të kujtohet gjatë për lëmshin e madh që shkaktoi gjyqtari kryesor me përdorimin e VAR-it në mënyrë të çuditshme, duke anashkalluar disa episode e duke vepruar ndoshta gabim në të tjerë. Ndeshja ishte shumë e luftuar nga të dyja skuadrat, të cilat kishin shanset e tyre për t'u kualifikuar më tej. Në fund të pjesës së parë, Kuarezma shënoi një supergol me "trivela", specialitetin e tij, duke mbyllur në avantazh këtë fraksion loje për portugezët, që e panë veten kryesues të grupit. Ronaldo humbi mundësinë të dyfishonte shifrat me një penallti zemërgjerë të akorduar me VAR, pasi goditja e tij u prit nga portieri i Iranit, ndërsa më pas gjyqtari refuzoi disa herë që të kontrollonte aksione nëpërmjet teknologjisë në favor të iranianeve. Edhe vetë Ronaldo u ndëshkua nga VAR, por me një karton të verdhë, ndërsa iraniantët kërkonin të kuqin për të për gjest antisportiv. Në fund, po përsëri me një vendim të dis-



kutueshëm, gjyqtari akordoi një penallti për Iranin, i cili barazoi shifrat në 1-1 në shtesë dhe i hoqi Portugalisë kreun e grupit, duke e renditur në anën e vështirë të tabelës së ndeshjeve për rrugëtimin drejt finales. **SPANJË-MAROK**

Spanja luante për të ruajtur vendin e parë në grup, ndërsa Maroku për krenarinë e tij dhe për të mos dalë pa pikë nga ky Botëror, ndaj në "Kaliningrad Arena" u zhvillua një ndeshje e luftuar. Spanja e nis më mirë këtë 90-minutësh, por ata që

shënojnë të parët janë marokenët. Minuta e 14-të dhe Sergio Ramos e bën lëmsh në mbrojtje, duke i dhënë mundësi Butaibit të çelë rezultatin. Iberikët nuk pajtohën me këtë gol dhe nisnin menjëherë mësymjen në portën e Marokut, për ta ar-

ritur barazimin shumë shpejt, kur në minutën e 19-të Iniesta lëviz mjaft bukur në zonë dhe shërben Izkon, që e çon topin nën traversë. Në minutën e 81-të do të vijë edhe befasia e madhe, kur Maroku do të dalë sërish në avantazh. Zhvillime nga një goditje këndi, harkon Fajr, ndërsa En Nesiri gjuan me kokë duke mposhtur De Gean. Por ndërkohë, situata e Spanjës komplikohet, pasi Irani barazon ndaj Portugalisë dhe grupi B. Por për të larguar fantazmat nga Spanja mendon Iago Aspas, që me thembër realizon një gol shumë të bukur. Përfundon 2-2, me Spanjën që e mbyll grupin si forcë e parë dhe që në 1/8-at do ndeshet me Rusinë. **URUGUAI-RUSI**

Uruguai thyen Rusinë në ndeshjen që viente kreun e grupit dhe këtë e bën duke bindur me rezultat e lojë. Latinët triumfojnë 3-0 dhe e

mbyllin grupin A me 9 pikë të plota në 3 ndeshje, ndërsa Rusia nga ana tjetër ka zhgënjyer pritshmëritë. Për të besuarit e Çerçesovit, kjo ishte ndeshja e parë e vërtetë pas dy fitoreve të lehta me Arabinë dhe Egjiptin, çka tregoi dhe limitet e vërteta në lojë e organizatorëve të veprimtarisë. Uruguai shënon fillimisht me Luiz Suarez në minutën e 10-të, ndërsa 13 minuta më pas vjen autogoli Çerishev. Në limitet e kohës së rregullt, Edison Kavani do të shënojë golin e tretë për të tijtë dhe të parin për të në këtë Kupë Bote. **ARABI-EGJIPT**

Arabia Saudite ka mposhtur Egjiptin në sfidën e skuadrave të eliminuara të grupit A, por që ishin ende në kërkim të pikës së parë në këtë Kupë Bote. Skuadra e drejtuar Huan Antonio Pizi ka mundur të përmbysë epërsinë e përkohshme të djemtë të Hektor Raul Kuperit, që arritën të kalonin në avantazh me anë të Mohamed Salah në minutën e 22-të, kur El Said shërben mjaft bukur yllin e Liverpulit, i cili me një lob të lehtë mposht gardianin saudit. Arabia do të barazojë nga pika e bardhë, ndërsa nuk do të gabojë Al Fara, që i çon ekipet në pushimin e ndeshjes me rezultat in barabartë 1-1. Në kohën shtesë të ndeshjes, Al Davsari realizon golin e fitores për Arabinë, që e mbyll grupin në vendin e tretë me 3 pikë.

GRUPI C

Danimarka shpreson te një Francë e ngopur



sistem loje". Age Harejde e di se ndaj Francës do të jetë e vështirë, për shkak të cilësive që ka ekipi i "gjelave", por veç ndeshjes

që do të luajë mes tyre, trajneri i Danimarkës i ka sytë edhe nga Peruja. "Franca ka top-lojtarë në të gjitha pozicionet, por nuk ka shfaqur as ritmin e as superioritetin që pritej. Për ne është e vështirë, pasi shumë gjëra varen edhe nga Peruja, një ekip që nuk ka pasur fat në këtë Kupë Bote, një ekip energjik dhe me shumë lojtarë të mirë".

GRUPI D


Islanda ëndërron, Kroacia nuk hap rrugë



ishte tronditës, por jo për ne. Nëse kualifikohemi, do të ishte arritja më e madhe në futbollin tonë". Nga loja e Kroacisë varet fati i tri ekipeve, por Zlatko Daljç nuk kërkon të

merret me thashetheme, ndërsa deklaroi se kërkon fitore në përballjen kundër Islandës. "Nuk më intereson se çfarë thonë skuadrat e tjera. Ne shohim punën tonë. Se çfarë flasin të tjerët, është punë për ta. Ne na intereson të mposhtim Islandën për të qëndruar në krye të grupit. Kemi stilin tonë të lojës dhe do të jemi amy duke treguar kujdes nga topat e tyre të gjatë dhe nga goditjet standarde".

Fjalëkryqi (1)



- 37. Janë legjendat.
- 38. Nuk ka akoma një bebe.
- 39. Fillojnë mirë.
- 40. Janë brijnë në skuadër.
- 42. Shkruhet i shtati.
- 44. Nget edhe ajo e mirë
- 47. Mbahet në gisht.
- 48. Janë numrat 1, 3, 3...

VERTIKAL

- 1. Kanë shpate të tilla.
- 2. Janë edhe ato polare.
- 3. Janë mizorët.
- 4. Janë male në Rusi të tilla
- 5. Eshhtë nusja me vello.
- 6. Një rreth pa ekstreme.
- 7. Mbyllin kuvendin.
- 8. Në kryt të titujve
- 9. Diku në qendër.
- 10. Markë cigaresh.
- 13. Janë rrefimet e të pandehurit.
- 14. Janë penjtë për gjergjef.
- 16. Mbarojnë fare.
- 18. Janë stitë e... provimëve.
- 20. Mund të jenë fotografikë të tilla.

HORIZONTAL

- 1. Eshhtë babëzia.
- 8. Burton regjisor.
- 11. Skllavja e Abrahamit.
- 12. Një ditë në mbledhje.
- 14. Tyson i boksit.
- 15. Rrethojnë ringun.
- 17. Beson pa kufij.
- 19. Zola që shkroi Nana.
- 20. Eshhtë ankimum.
- 23. Pak elementarë
- 24. Janë me para në bankë.
- 26. Matet pa kufij.
- 27. Janë ngrehina për reparte fabrikash.
- 28. Një zog i verdhë.
- 29. Inicialet e Moravia-s.
- 31. Qytet gjerman.
- 34. Një zonjë që ha gurë.
- 35. Pak analogji.
- 36. I ka plasur të paturpit.

- 21. Vitet pa kufij.
- 22. Një fjalë për tutje.
- 24. Brown i Kodi i Da Vinci-t.
- 25. Eshhtë e akuzuara... injorante
- 26. Baldwin aktor
- 27. Një pjesë e kandidatëve.
- 28. Krenar pa çift.
- 30. Grazia Cucinotta.
- 32. Paul këngëtar.
- 33. Janë pëshëtjellat.
- 35. Inicialet e Moravia-s.
- 37. Pak makinacione.
- 38. Samuel bomber kamerunas.
- 40. Markë makine koreane.
- 41. Ente Kombëtare Durrës.
- 42. Fillojnë kurat.
- 43. Inicialet e Zemeckis regjisor.
- 45. Ekstreme në litar.
- 46. Fillojnë lejen.

Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


- 1. Satelit i Uranit.
- 6. Eshhtë edhe ai i Pallës.
- 11. Tiran pa kufij
- 12. Në krye të armatës.
- 13. Një Ibrahim violinist.
- 14. Qendër ditore.
- 15. Mund të jenë fotografikë.
- 17. Inicialet e Einstein.
- 18. Një mbishkrim në kryq.
- 20. Janë si vite.
- 21. Thurman aktore.
- 22. Të parat në irritim.
- 23. I preu Seneka.
- 25. Fillojnë ilustrimet
- 26. Isaac Asimov.
- 27. Një Vladimir kompozitor.
- 28. Janë në modë.
- 30. Janë zyrat... qeveritare
- 32. Me të nxjerrin trarë.

VERTIKAL


- 35. Një shkop, thupër.
- 37. Eshhtë Shqipëria e madhe.
- 39. U thyen në Salamina.
- 40. Një raport shumë i ngushtë.
- 41. Nota e diapzonit.
- 42. Fund heroi.
- 43. Një top në rretjë.
- 45. Gjysma alarmi.
- 46. Herët pa zë.
- 47. Sampras i tenisit.
- 48. Me to bëjnë triko.
- 49. Një gjuajtje fluturimthi në tenis.
- 50. Janë kokrrat e lisit.

VERTIKAL


- 1. I famshëm ai i Sifizit.
- 2. Mund të jetë e hollë dhe therëse.
- 3. Fillojnë rastësisht.
- 4. Një pjesë e napolitanëve.
- 5. Janë situatat e rrezikshme para portave.
- 6. Mund të jenë kundërajrore.
- 7. Lindin në kokë.
- 8. Gjysmë shtegu.
- 9. Hidhen të parat.
- 10. Eshhtë njeriu i përsosur.
- 13. Një fjalë për tutje.
- 15. Fundi i një samurai.
- 16. Mbyllen me epilog.
- 17. Bel i maupassant.
- 19. Inicialet e Redford.
- 23. I manifeston nxënësi i papërgatitur.
- 24. Në hyrje të tokës.
- 26. Pak impresioniste.
- 27. Janë metrat në sipërfaqe
- 29. Hapet një për ajër.
- 30. Gjysmë krenar.
- 31. Një hidrokarbur.
- 33. Vrau Hektorin.
- 34. Një film i rixhiruar.
- 36. Kuptat pa kufij.
- 38. Inicialet e Nolte aktor.
- 41. Ullmann aktore.
- 43. Një brilantinë moderne
- 44. Hotel pa kufij.
- 46. Ekstremë në hall.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

		6	8				5	
					9			
8	5		1		2			
5	6		4			8	7	
						9		
4			7				1	
9		5	2	1				
			9	4	8			
	7		6					1

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

1	3	9	2	4	5	7	8	6
6	4	2	7	8	3	9	1	5
5	7	8	9	1	6	2	3	4
4	2	7	8	3	9	5	6	1
9	5	6	4	2	1	3	7	8
8	1	3	5	6	7	4	9	2
7	9	1	6	5	4	8	2	3
2	6	5	3	7	8	1	4	9
3	8	4	1	9	2	6	5	7

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Argëtim filozofik

- Eshhtë më mirë të mbretërosh në ferr sesa të shërbesh në parajsë.
- Jemi të lirë të besojmë se jemi budallenj, por është budallallëk të mendojmë se jemi të lirë.
- Kur varfëria hyn nga dera, dashuria ikën nga dritarja.
- Bota përbëhet nga dembelë që duan të kenë para pa punuar, dhe idiotë të gatshëm për të punuar pa u pasuruar.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

K	3	U	L	T	14	4	9	7	4	19	M	A	S	H	U	R	K	A	I	R	A	K		
8	10	5	1	4	12	2	6	7	5	10	E	S	T	E	R	A	D	H	U	N	A			
10	4	7	4	1	2	8	10	6	4	7	5	I	R	T	E	A	T	E	R	M	I	N		
18			1	7	5	8	9	4	2	10	4	E	R	A	P	O	L	A	R	T	A			
6	5	1	6	2	10	5	2	5		12		K	E	L	P	O	L	E	M	I	K	A	T	
7	1		17	5		1	5	10	17	4	2	L		P	O	L	I	G	A	M	I			
2	5	10	17	4	2		4	10		6	15	5	E	T	A	P	I	K	A	T	R	E	L	
8		2	9	12		15		6	10	17	5		K	O	M	O	D	E	N	T	O	K	E	
18	10	5	16	19		6		4	8		10	1	T	R	I	S	E	T	M	N	U	N		
6		7	5		6	11	5		9	19	6	7	I	T	T	U	T	U	I	T	I	D		
4	11	4	7	6	2	6	1	5		7	17	6	K	A	D	E	T	K	O	S	H	L	E	
12	5	2	5		12	1	6	15	4	2		8	E	T	I	K	S	E	K	S	E	R	E	T

PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

HORIZONTAL

1. BURTON
8. BURTON
11. SKLLAVJA
12. NËMBLEDHJE
14. TYSON
15. RING
17. BESON
19. ZOLA
20. ANKIMUM
23. PAK
24. BANKË
26. MATET
27. REPARTET
28. ZOG
29. MORAVIA
31. QYTET
34. ZONJË
35. ANALOGJI
36. PATURPIT

VERTIKAL

1. TILLA
2. POLARE
3. MIZORËT
4. RUSI
5. VELLO
6. RRETH
7. KUVENDIN
8. TITUJVE
9. QENDËR
10. MARKË
13. PANDEHURIT
14. GJERGJEF
16. FARE
18. PROVIMËVE
20. FOTOGRIKË

FJALËKRYQI (2)

HORIZONTAL

1. URANI
6. PALLË
11. KUFIJ
12. ARMATË
13. IBRAHIM
14. QENDËR
15. FOTOGRIKË
17. EINSTEIN
18. MBISHKRIM
20. VITE
21. THURMAN
22. IRRITIM
23. SENEKA
25. ILUSTRIMET
26. ASIMOV
27. VLADIMIR
28. MODË
30. QEVERITARE
32. TRARË

VERTIKAL

35. THUPËR
37. SHQIPËRIA
39. SALAMINA
40. NGUSHTË
41. DIAPZONIT
42. HEROI
43. RRETJË
45. ALARMI
46. HERËT
47. TENISIT
48. TRIKO
49. FLUTURIMTHI
50. LISIT

Ehënie të mençura

- Mos qesh kur dikush tjetër qan ... sepse
- ftohtësia e lotit të tij, mund të ngrijë
- buzëgjesjen tënde
- Mos ndiq askënd... një person që të
- vlerëson ecën përkaht teje
- Bota është shumë e çuditshme. Njerëzit
- krenohen për atë që duhet të turpëroshin.
- Peshen e gabimeve e kupton vetem
- atëherë kur perballësh me njëzë që nuk
- falin

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

GSH

www.gsh.al

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

Tashmë edhe lundroni!

